



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Kavajë

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi Auditimin Financiar

të ushtruar në

Bashkinë Kavajë

Tiranë, mars 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtime	3
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-9
a	Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Kavajë	4-6
I.1	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	7-9
II	HYRJA	10-14
1	Objektivat dhe qëllimi	10
2	Identifikimi i çështjes	10
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10-11
4	Përgjegjësitë e audituesve	11
5	Kriteret e vlerësimit	11-12
6	Standardet e auditimit	12-13
7	Metoda e auditimit	13-14
8	Dokumentimi i auditimit	14
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14-54
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Kavajë	14-15
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	15
2.3	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	15-54
IV	REKOMANDIME	55-70

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit në Bashkinë Kavajë.

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit, Bashkisë Kavajë:

Bashkia Kavajë, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr. 68/2017, datë 24.07.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë. Bashkia e Kavajës është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 5 njësi administrative si vijon: Njësia Administrative Kavajë (qyteti), Njësitë Administrative Golem, Helmas, Synej, Luz i Vogël. Kavaja kufizohet në veri nga Bashkia Durrës, në lindje nga Bashkia Tiranë, në jug nga Bashkia Kavajë dhe në perëndim nga deti Adriatik. Bashkia e Kavajës shtrihet në një zonë kodrash të buta dhe fushash pjellore përreth Qytetit të Kavajës deri në detin Adriatik, ku gjenden plazhe pjesërisht ranore dhe pjesërisht shkëmbore. Qyteti i Kavajës është një qendër historike zejtare i cili e mori statutin e Kasabasë (ekuivalentin e titullit qytet) në vitin 1867.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Kavajë për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe raportimit financiar, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

-Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare. Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e

zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej **4,237 mijë lekë**, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve. Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik; Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese; Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese; Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët; Kontrolli sipas një treguesi; Verifikimi i transaksioneve Intervistimi; Raporte dhe informacione; Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave konstatohet se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 25 gjetje dhe ka dhënë 33 rekomandime, nga ku masa organizative 24 gjetje me 32 rekomandime dhe masa për shpërbllim dëmi 1 gjetje me 1 rekomandim.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Llogaria 520 *“Disponibilitete në thesar”* paraqitet më datë 01.01.2023, në vlerën 630,530,197 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 772,025,004 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 *“Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”* në vlerën 772,025,004 lekë dhe llogarisë 466 *“Kreditorë për mjete në ruajtje”* në vlerën 182,845,257 lekë. Llogaria *“Disponibilitete në thesar”* është nënvlerësuar në vlerën 182,845,257 lekë.

- Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 45,196,292 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 *“Materiale”* në vlerën 20,194,738 lekë dhe llogaria 32 *“Inventar i imët”* 25,001,554 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 26,443,939 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 63 *“Ndryshimi i gjendjes së inventarit”* e cila paraqitet në vlerën 7,531,853 lekë me një diferencë në vlerën 18,912,086 lekë pasi nuk pasqyrohet saktë gjendja e llogarisë 32 *“Inventar i imët”*.

- Gjendja e llogarisë 468 *“Debitorë të ndryshëm”* më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 708,667,017 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 747,814,846 lekë me një rritje në vlerën 39,147,829 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 *“Debitorë të ndryshëm”* nuk janë të përfshirë debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në shkresën me nr. 2257 prot., datë 19.04.2024, që Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të Ardhurave dhe Borxhit drejtuar Drejtorisë së Burimeve Ekonomike mbi borxhin tatimor progresiv më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 747,814,846 lekë pa përfshirë debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 *“Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë”* me kundërparti llogarinë 468 *“Debitorë të ndryshëm”*, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 *“Investime për aktive afatgjata jo materiale”* paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 *“Investime për aktive afatgjata materiale”* në vlerën 2,842,855,911 lekë dhe në total me të njëjtën vlerë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 *“Nga fondet e veta të investimeve”* e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 *“Teprica e granteve kapitale të brendshme”* në vlerën 0 lekë.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhësja e llogarive 401-408 *“Furnitorë e llogari të lidhura me to”* paraqitet në vlerën 33,232,495 lekë, 42 *“Detyrime ndaj personelit”* në vlerën 30,181,721 lekë, 431 *“Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”* në vlerën 1,748,837 lekë, 435 *“Sigurime shoqërore”* në vlerën 8,872,253 lekë, 436 *“Sigurime shëndetësore”* në vlerën 1,221,466 lekë, 464 *“Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë”* në vlerën 1,242,000 lekë dhe 467 *“Kreditorë të ndryshëm”* në vlerën 724,981,269 lekë ku totali shkon në vlerën 801,480,041 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 *“Operacione me shtetin (Të drejta)”* në vlerën 800,238,041 lekë.

- Çelja e llogarisë 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar”* më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 6,950,179,622 lekë. Llogaria 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar”* kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b *“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”* në vlerën 112,297,766 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 7,531,853 lekë sipas llogarisë 63 *“Ndryshimi i gjendjes së inventarit”*. Llogaria 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar”* debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 331,059,987 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 226,160,610 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b *“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”*. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar”* është mbivlerësuar në vlerën 1,536,878,023 lekë.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 *“Disponibilitete në thesar”* me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike, në pasqyrat financiare të vitit 2024, të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 32 *“Inventar i imët”* me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë, duke kuadruar me llogarinë 63 *“Ndryshimi i gjendjes së inventarit”*.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave, të Ardhurave dhe Borxhit të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 *“Debitorë të ndryshëm”* me kundërparti llogarinë 470 *“Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”*.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të evidentojë pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në llogaritë 230 - 231 *“Investime në proces”* me kundërparti llogaritë 105 *“Teprica e granteve kapitale të brendshme”*, 115 *“Nga fondet e veta të investimeve”* dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 *“Fondi Bazë”*.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 *“Operacione me shtetin (Të drejta)”* me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

- Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar”* me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Kavajë, KLSH ka dhënë **“Opinionin i modifikuar/kualifikuar me rezervë”** për pasqyrat financiare.

Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative, rekomandime për shpërblim dëmi dhe rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2023:

a. Opinioni i modifikuar/kualifikuar me rezervë:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Kavajë për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, nga auditimi në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Kavajë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të modifikuar, me rezervë”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Bazat për opinionin e modifikuar/kualifikuar me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 4,237 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2023, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2023, në vlerën 630,530,197 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 772,025,004 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 772,025,004 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 182,845,257 lekë. Llogaria “Disponibilitete në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 182,845,257 lekë.

- Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 45,196,292 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 20,194,738 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 25,001,554 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm

përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 26,443,939 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “*Ndryshimi i gjendjes së inventarit*” e cila paraqitet në vlerën 7,531,853 lekë me një diferencë në vlerën 18,912,086 lekë pasi është e gabuar gjendja e llogarisë 32 “*Inventar i imët*”.

- Çelja e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjajshme” më datë 01.01.2023, është në vlerën 2,123,904 lekë ndërkohë që në pasqyrat financiare çelja për këtë llogari është në vlerën 2,839,350 lekë me një diferencë në vlerën 715,446 lekë.
- Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 91,540,628 lekë është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie.
- Në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.
- Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 122,396,352 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, për projekt-studime të pa analizuar për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.
- Për llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*” nuk është përllogaritur normë amortizimi.
- Për llogarinë 210 “Troje, toka, terrene” është përllogaritur normë amortizimi në vlerën 878,207 lekë ndërkohë që duke u bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “*Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale*” i përmirësuar, pika 30, për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi.
- Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*” e pasqyruar në bilanc për vlerën 35,121,363 lekë dhe llogaria 211 “*Pyje, kullota, plantacione*” në vlerën 10,971,000 lekë, janë të paanalizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari.
- Në gjendjen e llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” në vlerën 1,261,507,049 lekë kosto historike është përfshirë vlera 263,494,134 lekë dhe llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 3,434,747,420 lekë kosto historike është përfshirë vlera 569,988,759 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë (në formë tabelore në programin E..) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.
- Sipas të dhënave analitike progresive të llogarisë 215 “Mjete transporti” më datë 31.12.2023, gjendja e aktiveve të kësaj llogarie paraqitet në vlerën 86,262,823 lekë, ndërkohë që nga të dhënat e kontabilizuara në Pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata neto (Vlera neto)” mbyllja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 115,814,921 lekë kosto historike me një diferencë në vlerën 29,552,098 lekë.
- Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” është mbivlerësuar në vlerën 599,090,510 lekë.
- Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 1,512,285,441 lekë është e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për investimet në proces. Nga analiza e kësaj llogarie gjendja e çeljes në vlerën 1,512,285,441 lekë + shtesën e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 1,287,219,125 lekë jep totalin e llogarisë në vlerën 2,799,504,566 lekë ndërkohë që në bilanc mbyllja e llogarisë më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 2,842,855,911 lekë me një diferencë në vlerën 43,351,345 lekë.

- Në gjendjen e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” janë kontabilizuar aktivet me objekt “Hartim projektim rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare B..” në vlerën 883,520 lekë dhe “Hartim projektim i zbatimit të rindërtimit kopsht çerdhe Golem” në vlerën 891,561 lekë të cilat duhet të përfshiheshin në llogarinë 230 “Për aktivet afatgjata jo materiale”. Llogaria 230 “Investime për aktivet afatgjata jo materiale” është nënvlerësuar në vlerën 1,775,081 lekë.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 2,842,855,911 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 2,842,855,911 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 33,232,495 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 30,181,721 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 1,748,837 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 8,872,253 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 1,221,466 lekë, 464 “Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë” në vlerën 1,242,000 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 724,981,269 lekë ku totali shkon në vlerën 801,480,041 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 800,238,041 lekë.

- Në gjendjen e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është përfshirë vlera prej 150,519,696 lekë e përbërë nga vendime gjyqësore në vlerën 45,616,172 lekë + mallra dhe shërbime në vlerën 21,660,099 lekë + investime në vlerën 83,243,425 lekë të cilat duhet të kontabilizohen në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

- Vlera e detyrimeve më datë 31.12.2023, për llogarinë 42 “Detyrime ndaj personelit” sipas udhër shpenzimeve dhe akt-rakordimit me Degën e Thesarit Kavajë është në vlerën 30,061,732 lekë ndërsa në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 30,181,721 lekë me një diferencë në vlerën 119,989 lekë.

- Llogaria 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 1,242,000 lekë është e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie.

- Për llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” disponohet analiza përkatëse vetëm për vlerën 64,476,038 lekë ndërsa, diferenca prej 118,369,219 lekë është e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësimin e vlerave të kësaj llogarie.

- Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk paraqitet e saktë për arsye se, në analizat përkatëse vlera e kreditorëve është 725,081,269 lekë ndërsa në bilanc në vlerën 724,981,269 lekë me një diferencë mos kontabilizimi në vlerën 100,000 lekë.

- Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 6,950,179,622 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 112,297,766 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 7,531,853 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 331,059,987 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 226,160,610 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” është mbivlerësuar në vlerën 1,536,878,023 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1088/1 prot., datë 11.09.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 11.09.2024, deri më 27.09.2024, në institucionin Bashkia Kavajë u krye auditimi “Mbi auditimin financiar” për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. M. H. (Përgjegjës grupi)
2. S. D., anëtar
3. J. M., anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIME DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

2. Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi baza të risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë së saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kavajë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Kavajë.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Titullari i institucionit në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike në cilësinë e nëpunësit zbatues, janë përgjegjës

përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, dhe aktet nënligjore të tjera.

4. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Kavajë në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit. Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësi të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Kavajë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit: Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.14, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;

- VKM nr. 248, datë 10.04.1998, “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237, datë 16.07.2015, “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 26, datë 27.09.2019, “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

6. Standardet e auditimit:

- ☐ VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.
- ☐ ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ☐ ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ☐ ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- ☐ INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”;
- ☐ INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- ☐ INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.;
- ☐ Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- ☐ Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- ☐ Manuali i Auditimit të Brendshëm;
- ☐ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.;
- ☐ Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metoda e auditimit: Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit¹:

¹ ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve);

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt;

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcakttoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre;

5. Konfirmim nga të tretët:

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër;

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkojnë fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.,.

-Verifikimi i transaksioneve është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

-Intervistimi është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

-Raporte dhe informacione janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

8. Dokumentimi i auditimit: Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar

i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi akt-konstatimin e mbajtur, Projekt Raportin e Auditimit dhe mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Kavajë”:

Zona Gjeografike: Bashkia e Kavajës kufizohet në veri nga Bashkia Durrës, në lindje nga Bashkia Tiranë, në jug nga Bashkia Rrogozhinë dhe në perëndim nga deti Adriatik. Qendra e kësaj Bashkie është qyteti i Kavajës. Bashkia e Kavajës është pjesë e Qarkut Tiranë dhe përbëhet nga 5 njësi administrative të cilat janë: (Kavaja, Synej, Luz i Vogël, Golem dhe Helmas). Në përbërjen e tyre këto njësi administrative përfshijnë gjithsej një qytet dhe 32 fshatra.

Qendra e Bashkisë	NjA	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Kavajë	Kavajë	Qyteti Kavajë
	Synej	Synej, Butaq, Rrikaj, Hajdaraj, Peqinaj, Rrakull, Bago
	Luz i Vogël	Luz i Vogël, Vorrozen, Beden, Blerimaj
	Golem	Golem, Kryemëdhenj, Tilaj, Seferaj, Golemas, Qerret, Karpen, Zik-Xhafaj, Kanaparaj, Agonas, Karpen i Ri
	Helmas	Helmas, Zikular, Lis-Patros, Shtodhër, Cetë, Momël, Habilaj, Collakaj, Kryezi, Cikallesh

Organizimi i Bashkisë Kavajë:

Bashkia Kavajë ka nën varësi njësitë shpenzuese;

Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve;

(Sektori i Çerdhes së Qytetit në Drejtorinë e Shërbimit Social)

Drejtoria Ekonomike e Arsimit;

(Agjencia e Arsimit Parashkollor dhe Shërbimet Mbështetëse të Arsimit Parashkollor, Para Universitar dhe Qendrat Kulturore)

Drejtoria Ekonomike e Kulturës;

(Drejtoria e Kulturës)

Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;

Sektori M.Z.SH (Shërbimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi)

Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore;

(Drejtoria e Kadastrës Urbane Dhe Menaxhimit të Aseteve Publike)

Sport Klub B.

(Sektori i Shumë Sporteve)

Funksionet kryesore të Bashkisë Kavajë kryhen në fushën e:

- Infrastrukturës dhe shërbimeve publike.

- Shërbimeve sociale. - Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.

- Mbrojtjes së mjedisit. - Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike.

- Zhvillimit ekonomik vendor.

- Sigurisë publike.

Gjendja Financiare e Bashkisë Kavajë:

Detyrimet e prapambetura deri më datë 31.12.2023, janë në masën 78% e shpenzimeve totale faktike në Bashkinë e Kavajës, më shumë se 25% duke dëshmuar për një situatë në vështirësi financiare. Detyrimet e prapambetura në muajin Dhjetor të vitit 2023 kanë qenë në vlerën 808,324,694 lekë ndërsa shpenzimet faktike janë në vlerën 1,035,793,404 lekë pra detyrimet ndaj totalit të shpenzimeve faktike janë në masën 78%.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregulator në fuqi.

2.1.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.1.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.1.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

2.1.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- ☐ Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- ☐ Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- ☐ Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- ☐ Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- ☐ Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- ☐ Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- ☐ Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- ☐ Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- ☐ Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të Bashkisë Kavajë për vitin ushtrimor 2023 janë të nënshkruara nga z. F. Q. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. F. Gj. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike në cilësinë e Nëpunësit Zbatues ku janë depozituar pranë Degës së

Thesarit Kavajë me shkresën nr. 3472 prot., datë 26.06.2024, dhe konfirmuar nga DTH Kavajë me shkresën nr. 147 prot., datë 27.06.2024, jashtë afatit ligjor prej 88 ditësh. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli V, “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore”, pika 118.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e Klasës 6 dhe Klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t’u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në E.. dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaktuesin e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësi, duke argumentuar shkaktuesin e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Kavajë për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2023, deri më datën 31.12.2023**. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuandrojnë me ato analitike.

Llogaritja e nivelit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2023:

000/Lekë

Bashkia Kavajë 2023, Materialiteti për shpenzimet			
Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për t'u shqyrtuar
Paga (600)	118,192	0,70	24
Sigurime Shoqërore (601)	19,930	0,70	4
Mallra e Shërbime (602)	37,809	0,70	8
Investime të brendshme (230-231)	33,487	2,00	20
Të tjera transferime korrente (606)	2,432	0,70	0
Total	211,850		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	4,237		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	4,237		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	424		
Nëntotali	3,813		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	3,432		
Bashkia Kavajë 2023, Materialiteti për të ardhurat			
Emërtimi i të ardhurave	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për t'u shqyrtuar
Të ardhurat nga buxheti	0	0,70	0
Të ardhurat e veta	65,790	0,70	43
Total	65,790		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti	1,316		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	1,316		

Gabimi i lejuar (10%-20%)	132		
Nëntotali	1,184		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
Vlera e precizionit	1,066		

Procesi i inventarizimit:

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”, Pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjesimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.,. Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” konstatohet se, janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive në vlerën totale prej 63,444,338 lekë që i përkasin llogarive 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 18,000,000 lekë, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 2,154,130 lekë, 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 2,543,715 lekë dhe 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 40,746,493 lekë. Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve sipas llogarive të sipërpërmendura i përket procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit për vitin 2022, por si veprim është kontabilizuar në pasqyrat financiare ushtrimore të vitit 2023. Nga auditimi i procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të Bashkisë Kavajë dhe njërive të varësisë për **vitin 2022** konstatohet se:

- Me Urdhrin nr. 325/1, datë 26.10.2022, të z. R. K. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të Bashkisë Kavajë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2022, i përbërë nga znj. B. A. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. M. D., z. G. L.
- Me Urdhrin nr. 54, datë 24.02.2023, të z. R. K. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të propozuara për jashtë përdorimit nga komisioni i inventarizimit i përbërë nga z. E. B. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. R. K., z. M. K., z. G. L., znj. Xh. G.
- Me Urdhrin nr. 789, datë 02.10.2023, të z. F. Q. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për asgjesimin e aktiveve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit i përbërë nga z. J. K. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. M. K., z. M. R., z. G. J., z. K. M., z. E. N., z. S. P., z. G. B., z. E. D., z. B. K., z. R. T., znj. F. H.
- Me Vendimin nr. 23, datë 23.03.2023, të Këshillit Bashkiak Kavajë është miratuar propozimi për nxjerrje jashtë përdorimit të materialeve të Bashkisë Kavajë dhe institucioneve në varësi të saj.
- Me shkresën nr. 512/1 prot., datë 07.04.2023, Prefekti i Qarkut Tiranë ka dhënë konfirmimin mbi bazueshmërinë ligjore të VKB Kavajë nr. 23, datë 23.03.2023.
- Me shkresën nr. 4704/1 prot., pa datë, komisioni për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit i përbërë nga z. J. K. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. M. K., z. M. R., z. G. J., z. K. M., z. E. N., z. S. P., z. G. B., z. E. D., z. B. K., z. R. T., znj. F. H. ka hartuar procesverbalin për asgjesimin e aktiveve të vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit të Bashkisë Kavajë dhe institucioneve të varësisë. Në mënyrë të përmbledhur paraqitet vlera e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit sipas institucioneve respektive si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emërtimi i institucionit	327	218	214	213	212	Totali
1	Bashkia Kavajë	291,202	19,006,448	0	0	0	19,297,650
2	Arsimi	927,452	12,618,329	0	0	0	13,545,781
3	Njësitë Administrative	3,614,071	9,121,716	2,543,715	2,154,130	18,000,000	35,433,632
Totali		4,832,725	40,746,493	2,543,715	2,154,130	18,000,000	68,277,063

Shënim: Aktivitet që i përkasin llogarisë 327 “Inventar i imët” në vlerën 4,832,725 lekë nuk janë kontabilizuar në Pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” por evidentohet në ndryshimin e gjendjes së Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”.

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me aktivet e nxjerra jashtë përdorimit dhe asgjësimit të tyre për vitin 2022 konstatohet se:

Në listën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cilat konsiderohen të dëmshme, për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore. Nga Kryetari i Bashkisë nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre dhe nuk disponohet asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejin e asgjësimit dhe groposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet. Vlera totale e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit është **68,277,063 lekë**. Komisioni për tjetërsim dhe asgjësim, me shkresën nr. 4704/1 prot., pa datë, ka mbajtur procesverbalin lidhur me kryerjen e asgjësimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit, por në të citohet se: “..... Bazuar në VKB-në nr. 23, datë 23.03.2023, “Mbi propozimin e nxjerrjes jashtë propozimit të materialeve të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë të Bashkisë Kavajë” dhe miratimin nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr. 512 prot., datë 07.04.2023, komisioni u njoh me aktivet të cilat ishin për asgjësim, Shkolla “M. B.”, “A. M.”, “F. K.”, “3 D.”, “R.”, Kopshti “D.” edhe bëri të mundur grumbullimin e tyre në ambiente të jashtme të institucionit, fotografimin, shkatërrimin, groposjen dhe më pas djegjen e tyre”. Nga sa më sipër konstatohet se **nuk vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion, mënyra e asgjësimit, transportit si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit**. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, VKM nr. 957, datë 19.12.2012, “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, Kreu I, pika 1, dhe pika 2, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 122.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. J. K., z. M. K., z. M. R., z. G. J., z. K. M., z. E. N., z. S. P., z. G. B., z. E. D., z. B. K., z. R. T., znj. F. H. në cilësinë e anëtarëve të komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2022.

Për vitin 2023, me Urdhrin nr. 843/4, datë 17.10.2023, të z. F. Q. Kryetari i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve të Bashkisë Kavajë i përbërë nga znj. B. A. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. D. M., z. G. L.

- Me Urdhrin nr. 843, datë 17.10.2023, të z. F. Q. Kryetari i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve të Arsimit Parashkollor (Kopshte, Çerdhe dhe QKF) i përbërë nga znj. B. A. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. E. D., znj. E. O.

- Nga auditimi i realizimit të procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit konstatohet se, përbërja e komisionit të inventarizimit të aktiveve është i njëjti për vitet 2022-2023. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 84.

- Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej Nëpunësit Autorizues të institucionit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 85, gërma “c”.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. B. A., znj. D. M., z. G. L., znj. E. D., znj. E. O. në cilësinë e anëtarëve të komisionit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2023, të pozicionit financiar të Bashkisë Kavajë, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

		Lekë
Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto		8,821,691,671
Aktivet		9,841,645,181
Pasivet		1,019,953,510
Aktivet Neto		8,821,691,671

		Lekë
Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2023		4,148,591,134
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”		2,460,929,069
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”		45,196,292
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”		1,642,465,773

Aktivet Neto më datë 01.01.2023, paraqiten në vlerën 7,580,709,819 lekë ndërsa në mbyllje më datë 31.12.2023, në vlerën 8,821,691,671 lekë. **Më datën 27.06.2024, ora 13:51 nga Dega e Thesarit Kavajë** është gjeneruar **Raporti Kuadruës** mbi pasqyrat financiare ushtrimore të Bashkisë Kavajë për vitin 2023. Në përfundim të veprimeve të kryera në këtë Raport, Aktivet Neto më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 8,048,424,727 lekë **me një diferencë në vlerën 773,266,944 lekë** ndërmjet pasqyrave financiare dhe raportit të gjeneruar nga Dega e Thesarit Kavajë. Kjo situatë ka ndodhur për arsye se, Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, në këtë raport paraqitet me vlerën 0 lekë ndërkohë që në pasqyrat financiare kjo klasë paraqitet në vlerën 773,266,944 lekë e cila përbëhet nga llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” në vlerën 772,025,004 lekë + llogaria 50 “Letra me vlerë” në vlerën 1,242,000 lekë.

Si dhe,

Çelja e Klasës 4 “Llogari të pagueshme” në pasqyrat financiare më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 933,210,433 lekë ndërsa në raportin e gjeneruar nga Dega e Thesarit Kavajë kjo klasë është në vlerën 1,641,877,450 lekë **me një diferencë në vlerën 708,667,017 lekë**. Kjo situatë ka ndodhur për arsye se llogaria 4341 “Të tjera operacione me shtetin (kreditorë)” paraqitet si në çelje dhe në mbyllje të pasqyrave financiare në vlerën 0 lekë ndërkohë që në raportin e gjeneruar nga Dega e Thesarit Kavajë paraqitet çelja më datë 01.01.2023, në vlerën 708,667,017 lekë ndërsa mbyllja më datë 31.12.2023, në vlerën 0 lekë.

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	772,025,004	630,530,197	141,494,807
50	Letra me vlerë	1,242,000	1,980,000	(738,000)
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizione zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		773,267,004	632,510,197	140,756,807

- **Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”** paraqitet më datë 01.01.2023, në vlerën 630,530,197 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 772,025,004 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 772,025,004 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 182,845,257 lekë. Llogaria “Disponibilitete në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 182,845,257 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 49-50.

- **Llogaria 50 “Letra me vlerë”** më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 1,980,000 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 1,242,000 lekë me një pakësim në vlerën 738,000 lekë e cila përfaqëson letrat me vlerë konkretisht pullat e Gjendjes Civile.

2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
31	Materiale	20,194,738	7,531,853	12,662,885
32	Inventar i imët	25,001,554	11,220,500	13,781,054
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		45,196,292	18,752,353	26,443,939

Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 45,196,292 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 20,194,738 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 25,001,554 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 26,443,939 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 7,531,853 lekë me një diferencë në vlerën 18,912,086 lekë pasi nuk pasqyrohet saktë gjendja e llogarisë 32 “Inventar i imët”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 4.1 “Shpenzimet në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe operacionet që lidhen me to”.

- **Llogaria 31 “Materiale”,** ka vlerën 20,194,738 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë		Vlera	Lekë
Çelje e vitit 2023		7,531,853	
Shtesa (K)		Nuk disponohet informacion	
Pakësime (D)		Nuk disponohet informacion	
Gjendja në 31.12.2023		20,194,738	

- **Llogaria 32 “Inventarë i imët”,** ka vlerën 25,001,554 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë		Vlera	Lekë
Çelje e vitit 2023		11,220,500	
Shtesa (K)		1,423,915	
Pakësime (D)		4,832,725	
Gjendja në 31.12.2023		25,001,554	

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022	Lekë
	Llogari të arkëtueshme				
411	Klientë e llogari të ngjashme	2,872,258	2,839,350	32,908	
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	91,540,628	91,540,628	0	
431	Tatime e taksa	0	0	0	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0	
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0	
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0	
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0	
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0	
44	Institucione të tjera publike	0	0	0	
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0	
468	Debitorë të ndryshëm	747,814,846	708,667,017	39,147,829	
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	800,238,041	931,230,433	(130,992,392)	
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0	
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0	
	Totali	1,642,465,773	1,734,428	1,640,731,345	
	Të tjera aktive afatshkurtra	0	0	0	
409	Parapagime	0	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0	
	Totali	0	0	0	

- Gjendja e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 2,839,350 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 2,872,258 lekë me një rritje në vlerën 32,908 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 411 “Klientë e llogari të ngjashme”		Lekë
Çelje e vitit 2023		2,839,350
Shtesa (K)		Nuk disponon informacion
Pakësime (D)		Nuk disponon informacion
Gjendja debitore në 31.12.2023		2,872,258

Llogaria 411 “Klientë e llogari të ngjashme”							Lekë
Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023	Totali	
Çerdhja	40,560	212,621	217,971	210,180	211,249	892,581	
Kopshti	294,105	468,935	471,491	208,041	537,105	1,979,677	
Totali	334,665	681,556	689,462	418,221	748,354	2,872,258	

Në gjendjen e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjajshme” janë përfshirë detyrimet që kanë Çerdhet dhe Kopshtet e qytetit ndaj institucionit. Bashkia Kavajë nuk disponon të dhëna mbi shtesat apo pakësimet për vitin 2023 për këtë llogari. Referuar të dhënave analitike progresive të vënë në dispozicion nga Bashkia Kavajë, çelja e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjajshme” më datë 01.01.2023, është në vlerën 2,123,904 lekë ndërkohë që në pasqyrat financiare çelja për këtë llogari është në vlerën 2,839,350 lekë me një **diferencë në vlerën 715,446 lekë**. Diferenca prej 715,446 lekë e pasqyruar në bilanc është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie. Llogaria 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitoare të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në kredi të llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 4.2, “Të ardhurat në NjQP dhe operacione që lidhen me to”.

- Gjendja e llogarisë 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 91,540,628 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 91,540,628 lekë pra kjo llogari nuk ka shtesa apo pakësime. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”		Lekë
Çelje e vitit 2023		91,540,628
Shtesa (K)		0
Pakësime (D)		0
Gjendja debitoare në 31.12.2023		91,540,628

- Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 91,540,628 lekë është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.2, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 5 “Llogaritë financiar”.

- Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 708,667,017 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 747,814,846 lekë me një rritje në vlerën 39,147,829 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		Lekë
Çelje e vitit 2023		708,667,017
Shtesa (K)		73,165,568
Pakësime (D)		34,017,739
Gjendja debitoare në 31.12.2023		747,814,846

Përmbledhësja e Debitorëve		Lekë
Nr.		Gjendja 01.01.2023
1	Kavajë Biznes i madh + i vogël + abonentë familjarë	101,625,247
2	Njësia Administrative Golem Biznes i madh + i vogël + abonentë familjarë	532,275,125
3	Njësia Administrative Synej Biznes i madh + i vogël + abonentë familjarë	20,174,530
4	Njësia Administrative Luz Biznes i madh + i vogël + abonentë familjarë	24,947,183
5	Njësia Administrative Helmas Biznes i madh + i vogël + abonentë familjarë	35,300,500
6	Qira truall, objekte, hapësira publike, plazhe, pyje kullota	15,525,594
7	Liçensa, autorizime për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre	7,916,667

8	Gjoha IMTV	10,050,000
Totali		747,814,846

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë të përfshirë debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në shkresën me nr. 2257 prot., datë 19.04.2024, që Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të Ardhurave dhe Borxhit drejtuar Drejtorisë së Burimeve Ekonomike mbi borxhin tatimor progresiv më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 747,814,846 lekë pa përfshirë debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. Si dhe nga auditimi konstatohet se, në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 7.

- Gjendja e llogarisë 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 931,230,433 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 800,238,041 lekë me një pakësim në vlerën 130,992,392 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)		Lekë
Çelje e vitit 2023		931,230,433
Shtesa (K)		Nuk disponohet informacion
Pakësime (D)		Nuk disponohet informacion
Gjendja debitore në 31.12.2023		800,238,041

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” dhe 23 “Investime në proces” përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
	II. Aktive Afatgjata	3,824,031,201	6,164,008,486	(2,339,977,285)
20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	125,701,201	123,926,424	1,774,777
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	125,701,505	123,926,424	1,775,081
203	Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjashme	0	0	0
21	2. Aktive Afatgjata materiale	3,698,329,696	3,813,967,621	(115,637,925)
210	Toka, Troje, Terene	35,121,363	35,028,041	93,322
211	Pyje, Plantacione	10,971,000	10,971,000	0
212	Ndërtesa e konstruksione	1,112,080,616	1,170,611,175	(58,530,559)
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	2,405,231,778	2,531,822,925	(126,591,147)
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	5,504,354	6,880,442	(1,376,088)
215	Mjete transporti	41,728,542	17,267,009	24,461,533

216	Rezerva shtetërore	0	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	87,692,043	41,387,028	46,305,015
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	713,829,000	713,829,000	0
25	Huadhënie e nën-huadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	713,829,000	713,829,000	0
	4. Investime	2,842,885,911	2,842,885,911	0
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	0
231	Për Aktive Afatgjata materiale	2,842,855,911	2,842,855,911	0

1. Aktivët Afatgjatë Jomateriale.

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 123,926,424 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,775,081 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 125,701,505 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

				Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		123,926,424
	2	Amortizim i akumuluar		0
	3	Gjendja në 01.01.2023		123,926,424
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)		1,775,081
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		125,701,505
	5	Amortizim i akumuluar		0
	6	Gjendja më datë 31.12.2023		125,701,505

					Lekë
Studime-Projektme (kosto historike)		Gjendja 01.01.2023	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2023
Objekte inventari					
Hartim projektim i godinës së nënprefekturës		1,022,300			
Hartim projektim i kopështit Luz i Vogël		431,652			
Studim projektim të rrjetit të ujërave të zeza Kavajë		76,120			
Hartim projektim Shkolla 9-vjeçare B..			883,520		
Hartim projektim kopshti dhe çerdhe G..			891,561		
Totali		123,926,424	1,775,081		125,701,505

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Shënim: 123,926,424 lekë – 1,530,072 = 122,396,352 lekë e pa analizuar në kontabilitet.

Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 122,396,352 lekë e aktiveve afatgjatë jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për projekt-studime të pa analizuar për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik. Për këto vlera duhet të detajohen sipas investimeve dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b, “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit-Llogaria 202” “Studime dhe Kërkime”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e

klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5.

- Nga auditimi konstatohet se, për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” nuk është përlllogaritur normë amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 66-69, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 2, klasa 2 “Trajtimi kontabël për aktivet afatgjata materiale”, germa “d”, pika 36, “Për aktive afatgjata jo materiale, amortizimit të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimit 15%”.

2. Aktivet Afatgjata Materiale

- **Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 35,028,041 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 93,322 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 878,207 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 35,121,363 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”				Lekë
Referenca	Nr.	Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		35,906,248
	2	Amortizim i akumuluar		878,207
	3	Gjendja në 01.01.2023		35,028,041
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)		93,322
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		35,999,570
	5	Amortizim i akumuluar		878,207
	6	Gjendja më datë 31.12.2023		35,121,363

- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” konstatohet se, për llogarinë 210 “Troje, toka, terrene” është përlllogaritur normë amortizimi në vlerën 878,207 lekë. Bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pika 30, citohet se: “Vlera e amortizueshme e një elementi të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përrjashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen. Punimet e artit të marra për qëllime projektimi, si dhe veprat e muzeve dhe librat, që duhet të zëvendësohen pas një periudhe kohe të caktuar, amortizohen gjatë jetës së tyre të dobishme”. Në kushte të tilla për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi.

- **Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 10,971,000 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 10,971,000 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”				Lekë
Referenca	Nr.	Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		10,971,000
	2	Amortizim i akumuluar		0
	3	Gjendja në 01.01.2023		10,971,000
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)		0
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)		0

7	Amortizim nga pakësimet	0
4	Kosto historike	10,971,000
5	Amortizim i akumuluar	0
6	Gjendja më datë 31.12.2023	10,971,000

- Për sa trajtuar më sipër llogaria 210 “Toka, troje, terrene” e pasqyruar në bilanc për vlerën 35,121,363 lekë dhe llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” në vlerën 10,971,000 lekë, janë të paanalizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, Kapitulli “Trajtimi Kontabël për Aktivet Afatgjata të Investuara”, pikat 47-54, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

- **Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”** më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 1,170,611,175 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur pakësime në vlerën 260,630,317 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 149,426,433 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,112,080,616 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në Aneksin nr. 1. Tabela nr. 1.) në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”				Lekë
Referenca	Nr.	Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		1,522,137,366
	2	Amortizim i akumuluar		351,526,191
	3	Gjendja në 01.01.2023		1,170,611,175
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)		0
	5	Amortizim i shtesës		58,530,559
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)		260,630,317
	7	Amortizim nga pakësimet		260,630,317
	4	Kosto historike		1,261,507,049
	5	Amortizim i akumuluar		149,426,433
	6	Gjendja më datë 31.12.2023		1,112,080,616

- **Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 2,531,822,925 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur pakësim në vlerë 2,154,130 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 1,029,515,642 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,405,231,778 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në Aneksin nr. 1. Tabela nr. 2.) në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”				Lekë
Referenca	Nr.	Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		3,436,901,550
	2	Amortizim i akumuluar		905,078,625
	3	Gjendja në 01.01.2023		2,531,822,925
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)		0
	5	Amortizim i shtesës		126,591,146
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)		2,154,130
	7	Amortizim nga pakësimet		2,154,130
	4	Kosto historike		3,434,747,420
	5	Amortizim i akumuluar		1,029,515,642
	6	Gjendja më datë 31.12.2023		2,405,231,778

a. Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 1,261,507,049 lekë kosto historike është përfshirë vlere 263,494,134 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë (në formë tabelore në programin E..) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Pjesë e analizës së kësaj llogarie janë kontabilizuar 5

objekte pa vlerë me emërtimin “Njësia Administrative Golem”; “Shkolla 9 vjeçare Golem”; “Shkolla 9 vjeçare Qerret”; “Shkolla 9 vjeçare Kanaparaj”; “Shkolla 9 vjeçare Karpen”.

b. Në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,434,747,420 lekë kosto historike është përfshirë vlera 569,988,759 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë (në formë tabelore në programin E..) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30. Në mënyrë të përmblëdhur të dhënat paraqiten si më poshtë:

Lekë				
Llogaria	Luz i Vogël	Golem	Synej	Totali
212 “Ndërtesa e konstruksione”	168,032,051	12,176,243	83,285,840	263,494,134
213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”	218,684,174	82,563,335	268,741,250	569,988,759
Totali	386,716,225	94,739,578	352,027,090	833,482,893

- Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 6,880,442 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur pakësime në vlerën 23,767,541 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 35,848,253 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 5,504,354 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	65,120,148
	2	Amortizim i akumuluar	58,239,706
	3	Gjendja në 01.01.2023	6,880,442
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	1,376,088
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	23,767,541
	7	Amortizim nga pakësimet	23,767,541
	4	Kosto historike	41,352,607
	5	Amortizim i akumuluar	35,848,253
	6	Gjendja më datë 31.12.2023	5,504,354

- Llogaria 215 “Mjete transporti” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 17,267,009 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 34,893,668 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 74,086,379 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 41,728,542 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në Aneksin nr. 1. Tabela nr. 3.) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 215 “Mjete transporti” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	80,921,253
	2	Amortizim i akumuluar	63,654,244
	3	Gjendja në 01.01.2023	17,267,009
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	34,893,668
	5	Amortizim i shtesës	10,432,135
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	115,814,921
	5	Amortizim i akumuluar	74,086,379
	6	Gjendja më datë 31.12.2023	41,728,542

Referuar të dhënave analitike përbërsëse të llogarisë 215 “Mjete transporti” në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, gjendja e aktiveve të kësaj llogarie paraqitet në vlerën 86,262,823 lekë ndërkohë që, nga të dhënat e kontabilizuara në Pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata neto (Vlera neto)” mbyllja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 115,814,921 lekë kosto historike me një diferencë në vlerën 29,552,098 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Nomeklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik, Kodi 2, Artikulli 21, Llogaria 215 “Mjete transporti”.

- **Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 41,387,028 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 75,535,695 lekë, pakësime në vlerën 40,746,493 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 68,931,502 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 87,692,043 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 218 “Inventar ekonomik”				Lekë
Referenca	Nr.	Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		121,834,343
	2	Amortizim i akumuluar		80,447,315
	3	Gjendja në 01.01.2023		41,387,028
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)		75,535,695
	5	Amortizim i shtesës		29,230,681
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)		40,746,493
	7	Amortizim nga pakësimet		40,746,493
	4	Kosto historike		156,623,545
	5	Amortizim i akumuluar		68,931,502
	6	Gjendja më datë 31.12.2023		87,692,043

- Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është mbivlerësuar në vlerën 599,090,510 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Kavajë me Nipt J.... është 653,394,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës me Nipt M..... Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Kavajë sipas Marrëveshjes “Për krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Sh.a Durrës” me nr. 1567 prot., datë 25.07.2022, është 55,538,490 lekë ose 8.5% ($8.5\% * 653,394,000 = 55,538,490$ lekë). Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Futboll Club Besa me Nipt K..... është 160,000,000 lekë. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Kavajë është 59,200,000 lekë ose 37% ($37\% * 160,000,000 / 100 = 59,200,000$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 713,829,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

4. Investimet

- Gjendja e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 1,512,285,441 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,287,219,125 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,842,855,911 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në Aneksin nr. 1. Tabela nr. 4.) në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 231 "Për aktive afatgjata materiale"		Lekë
Gjendje në 01.01.2023		1,512,285,441
Shtesa (K)		1,287,219,125
Pakësime (D)		Nuk disponohet informacion
Gjendja në 31.12.2023		2,842,855,911

Në gjendjen e llogarisë 231 "Për aktive afatgjata materiale" janë kontabilizuar aktivet me objekt "Hartim projektim rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare B.." në vlerën 883,520 lekë dhe "Hartim projektim i zbatimit të rindërtimit kopsht çerdhe Golem" në vlerën 891,561 lekë të cilat duhet të përfshiheshin në llogarinë 230 "Për aktivet afatgjata jo materiale". Llogaria 230 është nënvlerësuar në vlerën 1,775,081 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Aneksi nr. 1, Klasa 2 "Aktivet Afatgjata (Përbërja dhe trajtimi kontabël)".

-Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 "Investime për aktive afatgjata jo materiale" paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" në vlerën 2,842,855,911 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 2,842,855,911 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 "Nga fondet e veta të investimeve" e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 "Teprica e granteve kapitale të brendshme" në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Aneksi 1, germa "ç".

-Për sa trajtuar më sipër Drejtoria e Burimeve Ekonomike disponon të dhëna analitike vetëm për shtesën e vitit për vlerën 1,287,219,125 lekë por jo për vlerën 1,512,285,441 lekë që i përket çeljes së vitit 2023. Nga analiza e kësaj llogarie gjendja e çeljes në vlerën 1,512,285,441 lekë + shtesën e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 1,287,219,125 lekë jep totalin e llogarisë në vlerën 2,799,504,566 lekë ndërkohë që në bilanc mbyllja e llogarisë më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 2,842,855,911 lekë me një diferencë në vlerën 43,351,345 lekë.

Auditim mbi administrimin e aseteve, procedurave të inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Bashkia Kavajë me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 04.01.2023 ka miratuar numrin e përgjithshëm punonjësve dhe strukturën organizative sipas drejtorive/sectorëve për vitin 2023. Struktura e cila merret me administrimin e pasurive është Sektori i Strehimit dhe Regjistrimit të Pronave, pjese e Drejtorisë së Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike (DKUMAP). Ky sektor menaxhon punën për identifikimin dhe inventarizimin e pronave të paluajtshme të administruar për Bashkinë Kavajë, rritjen e standardeve në sektorët përkatës së strehimit dhe regjistrimit të pronave vendosjen e objektivave për arritjen e këtyre standardeve si dhe parashikon ecurinë e problematikave që trajtohen në këtë sektor. Si çdo institucion publik, edhe Bashkia Kavajë, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Kavajë i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrija e ish-komunave, aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Kavajë. Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Kavajë duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e

regjistrin kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj.,.

a. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Kavajë dhe Njësi Administrative Synej, Helmas, Luz i Vogël, Golem, nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre **brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji**”.

b. Sa më sipër grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Kavajë. Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Kavajë, në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, pra nuk ka një sektor/strukturë të posaçme, për inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar dhe më pas regjistrimin në kadastrë.

-Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, makineri pajisje vegla pune”, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nëpërmjet VKM-ve përkatëse, si më poshtë:

c. Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total **3,176 pasuri** si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **2,645 pasuri në pronësi** dhe **531 pasuri në përdorim** si më poshtë:

➤ **Bashkia Kavajë**

-Me VKM-në nr.1563, datë 26.11.2008 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kavajë, të Qarkut të Tiranë”, është miratuar lista inventarit me në total **690 pasuri nga të cilat 655 pasuri në pronësi dhe 34 pasuri në përdorim**. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) dhe përbëhet me 112 (njëqind e dymbëdhjetë) fletë.

➤ **Ish-Komuna Helmës sot Njësia Administrative Helmës e Bashkisë Kavajë**

-Me VKM-në Nr. 5, datë 06.01.2013 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Helmas, të Qarkut të Tiranë”. Lista me 100 (njëqind) fletë dhe përfundon me numër Rendor 702, është miratuar lista inventarit me **702 pasuri total** nga të cilat **419 pasuri në pronësi dhe 283 pasuri në përdorim**.

➤ **Ish-Komuna Synej sot Njësia Administrative Synej e Bashkisë Kavajë**

-Me VKM-në Nr.45, datë 19.01.2011 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Synej, të Qarkut të Tiranë”. Lista me 82 (tetëdhjetë e dy) fletë dhe përfundon me numër rendor 584 (pesëqind e tetëdhjetë e katër), është miratuar lista inventarit me **584 pasuri total** nga të cilat **401 pasuri në pronësi dhe 183 pasuri në përdorim**.

➤ **Ish-Komuna Golem sot Njësia Administrative Golem e Bashkisë Kavajë**

-Me VKM-në Nr. 370, datë 30.01.2013 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Golem, të Qarkut të Tiranë”, Lista me 110 (njëqind e dhjetë) fletë dhe përfundon me numër rendor 773 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tre), është miratuar lista inventarit me **773 pasuri total** nga të cilat **752 pasuri në pronësi dhe 21 pasuri në përdorim**.

➤ **Ish-Komunës Luz i Vogël sot Njësia Administrative Luz i Vogël**

-Me VKM-në Nr.4, datë 06.01.2011 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Luz i Vogël, të Qarkut të Tiranë”. Lista me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë dhe përfundon me numër rendor 427 (katërqind e njëzetë e shtatë), është miratuar lista inventarit me **427 pasuri total** nga të cilat **417 pasuri në pronësi dhe 10 pasuri në përdorim**.

- **Pyjet dhe Kullotat**, në bazë të **VKM nr. 433 datë 8.6.2016** “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, i ndryshuar sipërfaqet pyjore dhe kullosore.

Bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga subjekti, në tabelën e mëposhtme është pasqyruar numri i pronave sipas listës së inventarit, si dhe VKM-ve përkatëse të njësive Administrative dhe të Bashkisë Kavajë.

Tabela përmbledhëse e pronave sipas listës së inventarit.

Nr.	Bashkia/ Njësitë	Nr. i Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2023	Nr. i Praktikave të Certifikuara 2023	Nr. i Praktikave në proces	Nr. i Pronave të pa Regjistruara
1	Bashkia Kavajë	690	106	0	23	567
2	Nj.Ad.Golem	773	55	0	23	724
3	Nj.Ad.Luz i Vogël	427	2	0	6	412
4	Nj.Ad.Synej	584	13	0	4	497
5	Nj.Ad.Helmas	702	25	0	20	645
	Totali	3176	201	0	76	2845

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Shënim: Për pasuritë e llojit “arë”, “pa frute” dhe “pyll”, në VKM rezultojnë të renditura në total si pasuri “mëmë” dhe kur regjistrohen ndahen në pasuri “bija”.

Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total **3,176 pasuri** si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **2,645 pasuri në pronësi dhe 531 pasuri në përdorim**.

Në total në pronësi të Bashkisë Kavajë janë **2,645 pasuri**, nga të cilat **201 pasuri** janë të pajisura me certifikatë dhe **2,444 pasuri** nuk janë të pajisura me titull pronësie. Për sa trajtuar më sipër nga Bashkia Kavajë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të

pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu III, pika 35 dhe Kreu II, pika 16, neni 37, pika 1, Ligji nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30, **Gjatë vitin 2023**, nuk është regjistruar asnjë pronë dhe janë në proces regjistrimi **76** pronat. Të dhënat për pronat sipas fushës së përdorimit dhe informacionit mbi regjistrimin e tyre paraqiten në tabelat e mëposhtme për Bashkinë Kavajë dhe për njësitë Administrative:

Tabela mbi numrin e pronave të Bashkisë Kavajë:

Nr.	Lloji i pronës	Prona në inventarë	Prona të regjistruara	Prona në proces regjistrimi	Prona të pa regjistruara
1	Administratë	1	1	0	0
2	Arsim	11	0	0	11
3	Shëndetësi	7	0	0	7
4	Kulturë sport	6	0	0	6
5	Toka produktive	3	0	0	3
6	Truall	45	19	8	18
7	Shesh + Shërbime Publike	81	8	4	69
8	Rep Ushtarak	64	22	1	41
9	Rrugë dhe Trotuare	296	7	4	285
10	Vendstrehime	14	0	0	14
11	Magazina	6	0	6	6
12	Rezerva Shtetërore	33	0	0	33
13	Kanale	8		0	8
14	Kabinë Elektrike	67	1	0	66
15	Banesa Sociale	48	48	0	
Totali		690	106	23	567

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Tabela mbi numrin e pronave, Njësia Administrative Golem:

Nr.	Lloji i pronës	Prona në inventarë	Prona të regjistruara	Prona në proces regjistrimi	Prona të pa regjistruara
1	Administratë	2	0	0	2
2	Arsim	14	0	0	14
3	Shëndetësi	10	0	0	10
4	Kulturë sport	3	0	0	3
5	Shërbime funerale	10	2	0	8
6	Infrastrukturë	628	1	0	627
7	Toka produktive	25	11	12	2
8	Depo uji	2	0	0	2
9	Kanalizime	14	0	0	14
10	Toka pa frute	9	17	8	0
11	Stalla	1	0	0	1
12	Pyje	14	24	3	0
13	Vaska	21	0	0	21
14	Kampi fushor I mbrojtjes	2	0	0	2
15	Kabina Elektrike	10	0	0	10
16	Përrua	8	0	0	8
Totali		773	55	23	724

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Shënim: Pyjet janë në total 14 parcela të regjistruar brenda këtyre parcelave janë 24 pasuri

Shënim: Tokat pa frute janë në hedhur në totalin e VKM dhe të regjistruara 15 pasuri

Tabela mbi numrin e pronave, Njësia Administrative Luz i Vogël:

Nr.	Lloji i pronës	Pronat në inventarë	Prona të regjistruara	Prona në proces regjistrimi	Prona të pa regjistruara
1	Administratë	6	0	0	6
2	Arsim	8	0	1	7
3	Shëndetësi	5	0	0	5
4	Kulturë sport	1	0	0	1
5	Shërbime funerale	6	0	0	6
6	Infrastrukturë	354	0	1	353
7	Toka produktive	9	0	4	0
8	Sistemi ujitës	22	0	0	22
9	Kanalizime	0	0	0	0
10	Toka pa frute	4	2	0	0
11	Ambulanca	5	0	0	5
12	Vend strehime	7	0	0	7
Totali		427	2	6	412

Burimi: Drejtoria Kadastrës dhe e Menaxhimit të Aseteve Publike

Shënim: Tokat pa frute janë në hedhur në totalin e VKM me sipërfaqe në hektarë dhe të regjistruara janë 2 pasuri

Tabela mbi numrin e pronave, Njësia Administrative Synej:

Nr.	Lloji i pronës	Prona në inventarë	Prona të regjistruara	Prona në proces regjistrimi	Prona të pa regjistruara
1	Administratë	5			5
2	Arsim	7			7
3	Shëndetësi	7			7
4	Kulturë sport	3			3
5	Shërbime funerale	18			18
6	Infrastrukturë	365			365
7	Toka produktive	15	4	3	
8	Sistemi ujitës	29			29
9	Depo Uji	2			2
10	Vaska	5			5
11	Përrua	9			9
12	Toka pa frute	11	3		
13	Ekonomi pyjore	57	2	1	
14	Truall	45	4		41
15	Rrjet elektrik	6			6
Totali		584	13	4	497

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Shënim: Tokat pa frute janë në hedhur në totalin e VKM me sipërfaqe në hektarë dhe të regjistruara janë 5 pasuri

Tabela mbi numrin e pronave, Njësia Helmas:

Nr.	Lloji i pronës	Prona në inventarë	Prona të regjistruara	Prona në proces regjistrimi	Prona të pa regjistruara
1	Administratë	1	0	0	1
2	Arsim	12	0	0	12
3	Shëndetësi	4	0	0	4
4	Shërbime funerale	15	0	0	15
5	Infrastrukturë	337	1	0	336
6	Toka produktive	43	22	18	0
7	Ujësjellës Kanalizime	1	0	0	0
8	Truall	160	2	1	158
9	Vendstrehime	9	0	0	0
10	Rezervuare	6	0	1	5
11	Pyje	56	0	0	56
12	Sisteme Ujitje	41	0	0	41
13	Përrua	17	0	0	17
Totali		702	25	20	645

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Shënim: Tokat pa frute janë në hedhur në totalin e VKM me sipërfaqe në hektarë dhe të regjistruara janë 22 pasuri.

Nga komunikimi me subjektin pretendohet se problematikat e mos regjistrimit janë të natyrave të ndryshme. Pjesa më e madhe e këtyre praktikave ka vonesa në trajtim nga ana e ASHK-së Kavajë, sipërfaqe të konsiderueshme të pronës është e pa azhurnuar, ka diferencë dokument-fakt (sipërfaqja e inventarit e miratuar-me terrenin), ka mbivendosje të pronave.

Një pengesë tjetër në regjistrimin e pasurive shtetërore nga ana e bashkisë pretendohet të jetë **tarifa e regjistrimit**, e cila sjell kosto për buxhetin e bashkisë. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve rezulton se, për vitin 2023, planifikimi i bërë për regjistrimin e pasurive ishte në vlerën **200,000 (dyqind mijë) lekë** dhe janë shpenzuar vetëm **45,000 (dyzetë e pesë mijë) lekë, ku rezulton se bashkia nuk ka shpenzuar as vlerën e parashikuar në buxhet për të kryer regjistrimin e pasurive**. Nga komunikimi me subjektin konstatohet se nuk është ngritur një grup punë që do të ndjekë zbatimin e këtyre VKM si edhe regjistrimin e pronave në ASHK në kundërshtim me VKM nr. 1563, datë 26.11.2008, pika 2; VKM nr. 45, datë 19.01.2011; VKM nr. 4, datë 06.01.2011; VKM nr. 5, datë 06.01.2013; VKM nr. 370, datë 30.01.2013.

-Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Kavajë të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm **106 prej tyre janë të pajisura me certifikatë pronësie**. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Kavajë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të

sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV neni 37 pika 1, 2, gërmat “a-b”, Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Kavajë më datën 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,.

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 33,232,495 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 30,181,721 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 1,748,837 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 8,872,253 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 1,221,466 lekë, 464 “Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë” në vlerën 1,242,000 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 724,981,269 lekë ku totali shkon në vlerën 801,480,041 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 800,238,041 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë				
Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	33,232,495	150,519,732	(117,287,237)
42	Detyrime ndaj personelit	30,181,721	26,886,944	3,294,777
16,17,18	Hua afat shkurtra	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,748,837	1,547,676	201,161
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	8,872,253	7,922,424	949,829
436	Sigurime shëndetësore	1,221,466	1,091,356	130,110
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	1,242,000	1,980,000	(738,000)
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	182,845,257	128,019,940	54,825,317
467	Kreditorë të ndryshëm	724,981,269	615,242,361	109,738,908
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Gjendje në fund të periudhës		984,325,298	933,210,433	51,114,865

- **Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** më datë 01.01.2023, është në vlerën 150,519,732 lekë e cila paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Kavajë. Gjatë vitit 2023 ka pasur shtesa në vlerën 31,545,455 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e

kësaj llogarie paraqitet në vlerën 33,232,495 lekë. *(Ndërkohë që gjendja e kësaj llogaria më datë 01.01.2023, duhet të jetë 1,687,040 lekë).* Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelat si më poshtë:

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”		Lekë
Çelje e vitit 2023		150,519,732
Shtesa (K)		31,545,455
Pakësime (D)		Nuk disponohet informacion
Gjendja debitore në 31.12.2023		33,232,495

Lekë						
Nr.	Subjekti	Emërtimi i mallrave	Numri i faturave	Datë	Vlera	Llogaria e detyrimeve
1	A.	R.	29	15.02.2019	9,500	4864600
2	A.	Blerje artikuj festiv	70	22.12.2021	109,200	4864600
3	A. & D.	Blerje pajisje dhe aksesori audio	10	24.12.2021	300,000	4864600
4	R. G.	Blerje shtypshkrimesh	18	05.03.2022	119,640	4864600
5	T. K.	Blerje pajisje zyre	26	15.06.2022	318,900	4864600
6	D.	Blerje artikujsh për Drejtorinë e Shërbimit Social	137	05.04.2023	17,510	4864600
7	Sh.	Blerje çakulli	198	22.05.2023	13,800,000	4864600
8	G. Shpk	Furnizim me karburant	4553	25.08.2023	1,130,880	4864600
9	G. Shpk	Furnizim me karburant	5855	30.10.2023	17,376,365	4864600
10	T. M.	Blerje kompozimesh lule dhe kurorë	20	12.10.2023	7,000	4864600
11	D.	Blerje shtypshkrimesh	271	10.11.2023	43,500	4864600
Totali					33,232,495	

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Në gjendjen e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është përfshirë vlera prej 150,519,696 lekë e përbërë nga vendime gjyqësore në vlerën 45,616,172 lekë + mallra dhe shërbime në vlerën 21,660,099 lekë + investime në vlerën 83,243,425 lekë të cilat duhet të kontabilizohen në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.2, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4)”.

- **Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”** referuar pasqyrave financiare vlera 30,181,721 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2023 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2024, si më poshtë:

Urdhër shpenzimi			Lekë
Nr.	Datë	Vlera	
1	11.01.2024		3,946,465
2	11.01.2024		779,708
3	11.01.2024		153,976
4	11.01.2024		84,115
5	11.01.2024		499,140
6	11.01.2024		1,569,334
7	11.01.2024		698,414
8	11.01.2024		4,209,329
9	11.01.2024		2,479,171
10	11.01.2024		740,963
11	11.01.2024		343,188
12	11.01.2024		302,456
13	11.01.2024		205,248
14	11.01.2024		467,904
15	11.01.2024		1,073,774
16	11.01.2024		831,765
17	11.01.2024		542,570
18	11.01.2024		273,824
19	11.01.2024		619,901
20	11.01.2024		158,763

21	11.01.2024	54,255
22	11.01.2024	37,118
23	11.01.2024	35,520
24	11.01.2024	208,038
25	11.01.2024	152,211
26	11.01.2024	203,454
27	11.01.2024	109,372
28	11.01.2024	52,412
29	11.01.2024	77,859
30	11.01.2024	112,161
31	11.01.2024	4,828,486
32	11.01.2024	1,303,121
33	11.01.2024	122,545
34	11.01.2024	215,544
35	11.01.2024	527,986
36	11.01.2024	384,207
37	11.01.2024	49,623
38	11.01.2024	116,394
39	11.01.2024	264,541
40	11.01.2024	113,503
41	11.01.2024	122,786
42	11.01.2024	46,543
43	11.01.2024	198,536
44	11.01.2024	270,777
45	11.01.2024	278,414
46	11.01.2024	63,782
47	11.01.2024	64,661
48	11.01.2024	67,875
Totali		30,061,732

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Për sa trajtuar më sipër sipas udhër shpenzime dhe akt rakordimit me Degën e Thesarit Kavajë vlera e detyrimeve për llogarinë 42 “Detyrime ndaj personelit” është në vlerën 30,061,732 lekë ndërsa në bilanc është kontabilizuar vlera 30,181,721 lekë me një diferencë në vlerën 119,989 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr, 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.3, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4)”.

- Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 1,748,837 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2024, si më poshtë:

Urdhër shpenzimi		Vlera	Lekë
Nr.	Datë		
52	17.01.2024	639,819	
53	17.01.2024	49,436	
54	17.01.2024	53,599	
55	17.01.2024	65,434	
56	17.01.2024	10,607	
57	17.01.2024	58,730	
58	17.01.2024	32,399	
59	17.01.2024	5,574	
60	17.01.2024	15,888	
61	17.01.2024	16,567	
62	17.01.2024	20,738	
63	17.01.2024	104,605	
64	17.01.2024	48,250	
65	17.01.2024	2,551	
66	17.01.2024	14,232	
67	17.01.2024	72,006	
68	17.01.2024	367,542	
69	17.01.2024	16,129	
70	17.01.2024	138,611	
71	17.01.2024	16,120	
Totali		1,748,837	

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

- **Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2023 që paguhën në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 8,872,253 lekë. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2024, si më poshtë:

Urdhër shpenzimi		Vlera	Lekë
Nr.	Datë		
52	17.01.2024		2,410,915
53	17.01.2024		144,619
54	17.01.2024		306,668
55	17.01.2024		290,081
56	17.01.2024		65,371
57	17.01.2024		221,914
58	17.01.2024		131,576
59	17.01.2024		17,856
60	17.01.2024		74,591
61	17.01.2024		105,366
62	17.01.2024		187,864
63	17.01.2024		400,230
64	17.01.2024		642,419
65	17.01.2024		59,076
66	17.01.2024		135,831
67	17.01.2024		344,161
68	17.01.2024		2,204,926
69	17.01.2024		263,530
70	17.01.2024		812,829
71	17.01.2024		52,430
Totali			8,872,253

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

- **Llogaria 436 “Sigurime shoqërore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2023 që paguhën në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 1,221,466 lekë. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2024, si më poshtë:

Urdhër shpenzimi		Vlera	Lekë
Nr.	Datë		
52	17.01.2024		333,156
53	17.01.2024		20,070
54	17.01.2024		42,558
55	17.01.2024		33,434
56	17.01.2024		7,534
57	17.01.2024		30,796
58	17.01.2024		18,260
59	17.01.2024		2,478
60	17.01.2024		10,352
61	17.01.2024		14,622
62	17.01.2024		26,070
63	17.01.2024		55,542
64	17.01.2024		89,152
65	17.01.2024		8,198
66	17.01.2024		18,850
67	17.01.2024		47,762
68	17.01.2024		231,372
69	17.01.2024		74,618
70	17.01.2024		36,570
71	17.01.2024		112,796
72	17.01.2024		7,276
Totali			1,221,466

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

- **Llogaria 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë”**, e pasqyruar në bilanc për vlerën 1,242,000 lekë është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe

raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3 “Inventari, llogaritë e të tretëve si dhe llogarive financiare” (Përbërja dhe trajtimi kontabël i klasës 3, 4 dhe 5).

- **Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Kavajë në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 182,845,25 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Kavajë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në Aneksin nr. 1. Tabela nr. 5.) në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”		Lekë
Çelje e vitit 2023		128,019,940
Shtesa (K)		Nuk disponohet informacion
Pakësime (D)		Nuk disponohet informacion
Gjendja debitoare në 31.12.2023		182,845,257

- Për sa trajtuar më sipër nga gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” disponohet analiza përkatëse vetëm për vlerën 64,476,038 lekë ndërsa për diferencën në vlerën 118,369,219 lekë është e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësimin e vlerave të kësaj llogarie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.3, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4)”.

- Për 37 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Kavajë janë ngurtësuar fonde në vlerën 55,806,023 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Kavajë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 55,806,023 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

- **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 01.01.2023, janë në vlerën 615,242,361 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, në vlerën 724,981,269 lekë me një rritje në vlerën 109,738,908 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në Aneksin nr. 1. Tabela nr. 6.) në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”		Lekë
Çelje e vitit 2023		615,242,361
Shtesa (K)		Nuk disponohet informacion
Pakësime (D)		Nuk disponohet informacion
Gjendja kreditore në 31.12.2023		724,981,269

-Për sa trajtuar më sipër gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk paraqitet e saktë për arsye se, në analizat përkatëse vlera e kreditorëve është 725,081,269 lekë ndërsa në bilanc në vlerën 724,981,269 lekë me një diferencë mos kontabilizimi në vlerën 100,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për

disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.2, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4)”.

II. Pasivet Afat Gjata

- **Llogaria 16,17,18 “Huatë Afat Gjata”** më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 35,628,212 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, në vlerën 35,628,212 lekë. Përgjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime. Bashkia Kavajë ka marrë hua për ndërtimin e banesave sociale me afat 20 vjeçar (aktualisht viti i 11-të) bazuar në marrveshjen date 13.02.2008, midis (CEB) dhe Bashkisë Kavajë për kreditë e marrë nga Banka Qendrore Europiane (CEB) me ndërmjetësimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në rolin e institucionit garant. Bazuar në kushtet e kësaj marrveshjeje bashkia ka marrë përsipër pagesën e kësaj të kredisë me specifikimin se “në rast të mosrespektimit të pagesave ministria e financës do ta mbajë këtë detyrim nga transfertat e buxhetit qendror”. Nga auditimi u konstatua se për vitet 2022-2023 nuk ka kryer pagesën e planifikuar për kështet vjetore në vlerën 7,670,516 lekë. Në pasqyrat financiare të Bashkisë Kavajë kjo hua duhet të pasqyrohet si shpenzim konkretisht: Në kredi të Pasivet Afat Gjata/klasa 4 llogari të pagueshme, hua afat gjatë; Në debi tek të tjera aktive afatshkurtra, llog 481, shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime. Nga Auditimi u konstatua se për vitet 2022-2023 nuk ka informacion sa i përket kredisë së marrë nga Banka Qendrore Europiane (CEB) me ndërmjetësimin e MFE në rolin e institucionit garant të këtij detyrimi. Në kontabilitetin e bashkisë kjo kredi është pasqyruar si huamarrje por nuk ka të dhëna kontabël ku të tregohet historiku i transferimit të gjendjeve të llogarive të kësaj veprimtarie. Për këtë huamarrje Bashkia Kavajë nuk rezulton të ketë kryer pagesa për vitet 2022-2023 për kështet vjetore në vlerë 7,670,516 lekë. Bazuar në legjislacionin për kontabilitetin paraqitja e huasë në bilanc duhet: Në kredi të Pasivet Afat Gjata/klasa 4 llogari të pagueshme, hua afat gjatë; Në debi tek të tjera aktive afatshkurtra, llog 481, shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10-11, të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 3 pikat 4, 6., nenet 57-60, nenet 62, 63, 64, 67; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me UMF nr. 5, datë 21.02.2022, Aneksi 1, “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, si dhe në Udhëzimin e MFE nr. 34, datë 14.12.2022, “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”.

		Lekë	
C	AKTIVET NETO/FONDET (A-B)	8,821,691,671	7,580,709,819
D	FONDI I KONSOLIDUAR	8,821,691,671	7,580,709,819
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	8,049,666,667	6,950,179,622
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	772,025,004	630,530,197
111	Rezerva	0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve	0	0
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime	0	0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	0	0
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim	0	0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	0	0
	Të tjera	0	0
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	9,841,645,181	8,549,548,464

Lekë

Fondi i konoliduar	Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"			
	Mbyllje më datë 31.12.2023		Çelje më datë 01.01.2023	
8,821,691,671	Debi		Kredi	
			6,950,179,622	Çelja gjendja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" i datës 31.12.2023
	331,059,987	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	112,297,766	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	226,160,610	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	7,531,853	Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"
Totali	557,220,597		7,070,009,241	
	7,070,009,241-557,220,597=6,512,788,644			
	8,049,666,667-6,512,788,644=1,536,878,023			

- Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 6,950,179,622 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlëra neto)" në vlerën 112,297,766 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 7,531,853 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" debitohet për pakësimet e vitit në vlerën 331,059,987 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 226,160,610 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlëra neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" është mbivlerësuar në vlerën 1,536,878,023 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 17.

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

- Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet", në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 400,743,726 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 765,739,450 lekë ose me një rritje në vlerën 364,995,724 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	765,739,450	400,743,726
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	700,201	1,119,429
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	700,201	1,119,429
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	2. Tatimi mbi pasurinë	122,607,727	148,535,225
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	105,873,843	148,535,225
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	16,733,884	0
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	473,602,235	251,089,072
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	473,602,235	251,089,072
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksë mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0

705	5. Taksë e rrugës	0	0
708	6. Të tjera tatime e taksa kombëtare	0	0
709	7. Gjoha e kamatë vonesa	0	0

2. Të ardhurat jo tatimore:

- **Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”**, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 131,406,605 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 125,276,921 lekë ose me një pakësim në vlerën 6,129,684 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	125,276,921	131,406,605
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	7,793,144	7,914,111
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	7,793,144	7,914,111
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	117,483,777	123,492,494
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	101,206,906	112,712,175
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	3,226,371	4,566,567
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	1,922,000	1,341,000
7114	Të ardhura nga biletat	0	20,000
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	11,128,500	4,852,752
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	0	0

3. Grante korente:

- **Llogaria 72 “Grante korente”**, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 1,672,797,964 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,165,376,874 lekë ose me një pakësim në vlerën 507,421,090 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
72	V. GRANTE KORENTE	1,165,376,874	1,672,797,964
720	1. Grant korent i brendshëm	1,165,376,874	1,672,597,964
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	0	0
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	321,586,467	709,749,732
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme të ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficitit (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	43,552,366	10,912,099
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	800,238,041	933,210,433
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	0	0
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	18,725,700
721	2. Grant korent i huaj	0	200,000
	Nga Qeveri të Huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	200,000

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

- **Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”** në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 372,056,611 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 427,687,102 lekë ose me një rritje në vlerën 55,630,491 lekë.

- **Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”**, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 62,026,311 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 70,930,625 lekë ose me një rritje në vlerën 8,904,314 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Kavajë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
6001	Paga, personel i përhershëm	424,434,650	372,056,611
602	Paga personel i përkohshëm	0	0
603	Shpërblime	3,252,452	0
609	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	63,697,676	55,701,354
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	7,232,949	6,324,957
Totali		498,617,727	434,082,922

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

- **Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”**, në datë 31.12.2022, ka qenë në vlerën 548,762,865 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 476,377,088 lekë ose me një pakësim në vlerën 72,385,777 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Kavajë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	476,377,088	548,762,865
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	3,855,541	2,852,507
6021	Materiale dhe shërbime speciale	11,030,065	22,035,730
6022	Shërbime nga të tretë	381,860,201	438,309,103
6023	Shpenzime transporti	11,006,830	21,833,756
6024	Shpenzime udhëtimi	0	0
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	36,599,930	9,912,207
6026	Shpenzime për qiramarrje	8,050,687	5,548,493
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	22,771,673	46,879,719
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	1,202,161	1,391,350

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Kavajë nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 907,500 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 308,465,926 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
	V. TRANSFERIME KORENTE	309,373,426	0
604	1. Transferime korente të brendshme	907,500	0
6040	Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë	907,500	0
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	0	0
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	0	0
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	308,465,926	583,024,264
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	0	0
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendor	308,465,926	583,024,264

Për vitin 2023 totali i të ardhurave në vlerë është 2,056,393,245 lekë dhe totali shpenzimeve është 1,284,368,241 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 772,025,004 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 772,025,004 lekë.

Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletë-hyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.,. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Nga auditimi me zgjedhje i veprime të kryera me bankë janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:

a. Mbi pagesat e procesit të shpronësimeve:

Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës konstatohet se, Bashkia Kavajë përgjatë vitit 2023 ka kryer pagesa për shpronësimin e pasurive private me interes publik në zbatim të projektit “Unaza lindore Kavajë” konkretisht:

- Me Urdhër Shpenzimin nr. 554, datë 12.04.2023, Bashkia Kavajë ka kryer pagesën për shpronësimin e pasurisë private me interes publik për z. S. Gj., në vlerën 2,385,460 lekë;
- Me Urdhër Shpenzimin nr. 552, datë 12.04.2023, Bashkia Kavajë ka kryer pagesën për shpronësimin e pasurisë private me interes publik për z. A. Gj., në vlerën 1,590,307 lekë;
- Me Urdhër Shpenzimin nr. 1510, datë 03.10.2023, Bashkia Kavajë ka kryer pagesën për shpronësimin e pasurisë private me interes publik për z. N. K., në vlerën 1,394,100 lekë;
- Me Urdhër Shpenzimin nr. 1509, datë 03.10.2023, Bashkia Kavajë ka kryer pagesën për shpronësimin e pasurisë private me interes publik për z. M. M., në vlerën 390,348 lekë;
- Me Urdhër Shpenzimin nr. 1508, datë 03.10.2023, Bashkia Kavajë ka kryer pagesën për shpronësimin e pasurisë private me interes publik për z. E. M., në vlerën 348,525 lekë;

Shpronësimet e mësipërme janë kryer në zbatim të VKM nr. 551, datë 29.09.2021, “Për shpronësimin për interes publik të pronave të pasurive, pronë private, që preken nga projekti “Unaza lindore e Kavajës”.

Bashkëlidhur praktikës së pagesës disponohet dokumentacioni si më poshtë:

Urdhër Shpenzimi; VKM nr. 551, datë 29.09.2021, “Për shpronësimin për interes publik të pronave të pasurive, pronë private, që preken nga projekti “Unaza lindore e Kavajës”; Transaksioni bankar; Çertifikata e pronësisë; Karta e identitetit e noterizuar; Vërtetimi (noterial) i njehësuar me origjinalin.

Si dhe nuk disponohet dokumentacioni si më poshtë:

- Nuk disponohet urdhri për komisionin e posaçëm nga Agjencia Shtetërore e Shpronësimit, për ndjekjen dhe realizimin e procedura të shpronësimit;
- Nuk disponohet akt-marrëveshja midis ASHSH dhe Bashkisë;
- Nuk disponohet kërkesa për shpronësim e cila duhej të administrohej pranë zyrës së protokollit pranë Bashkisë nga pronari i kësaj pasurie;
- Nuk disponohet përlllogaritja e shpronësimit, në zbatim të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të pasurisë pronë private në interes publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 138, datë 23.03.2000, “Për kriteret e vlerësimit dhe përlllogaritjes të masës të shpërbllimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtat e personave të tretë, për

interes publik” i ndryshuar me VKM nr. 395, datë 13.05.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ASHSH”.

b. Lidhur me vonesat në likuidime:

Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se, në **6 raste** janë hasur vonesa në likuidimin e faturave pjesore apo përfundimtare (për situacionet e punimeve) të kontratave të punimeve, jashtë afate të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7 “Afati për autoritetet publike”. Konkretisht në mënyrë analitike paraqiten të dhënat si më poshtë:

1. Fatura tatimore me nr. 7/2022, datë 31.01.2022, në vlerën 51,427,200 lekë me Tvsh lëshuar nga OE “G. C.” Shpk që i përket Kontratës së Punimeve me nr. 1534/2 prot., datë 07.05.2020, me objekt “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës për furnizimin me ujë të qytetit Kavajë dhe ndërtimi i Depo Uji e re, faza e dytë”, të lidhur ndërmjet OE të sipërpërmendur dhe Bashkisë Kavajë, për Situacionin Pjesor nr. 4, likuiduar me Udhër Shpenzimin nr. 540, datë 11.04.2023, në vlerën 48,855,840 lekë (ku është zbritur edhe 5% i garancisë së punimeve në vlerën 2,571,360 lekë);
2. Fatura tatimore me nr. 6/2023, datë 31.01.2023, në vlerën 32,414,715 lekë me Tvsh lëshuar nga OE “S.” Shpk që i përket Kontratës së Punimeve me nr. 536/4 prot., datë 09.04.2021, me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “Q. Xh.”, të lidhur ndërmjet OE të sipërpërmendur dhe Bashkisë Kavajë, për Situacionin Pjesor nr. 5, likuiduar me Udhër Shpenzimin nr. 538, datë 11.04.2023, në vlerën 30,793,979 lekë (ku është zbritur edhe 5% i garancisë së punimeve në vlerën 1,620,736 lekë);
3. Fatura tatimore me nr. 42/2022, datë 31.07.2021, në vlerën 44,001,915 lekë me Tvsh lëshuar nga OE “G. C.” Shpk që i përket Kontratës së Punimeve me nr. 1534/2 prot., datë 07.05.2020, me objekt “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës për furnizimin me ujë të qytetit Kavajë dhe ndërtimi i Depo Uji e re, faza e dytë”, të lidhur ndërmjet OE të sipërpërmendur dhe Bashkisë Kavajë, për Situacionin likujdim total nr. 3, likuiduar me Udhër Shpenzimin nr. 481, datë 24.0.2023, në vlerën 41,801,819 lekë (ku është zbritur edhe 5% i garancisë së punimeve në vlerën 2,200,819 lekë);
4. Fatura tatimore me nr.119/2022, datë 09.12.2022, në vlerën 93,310,560 lekë me Tvsh lëshuar nga OE “B.” Shpk që i përket Kontratës së Punimeve me nr. 509/3 prot., datë 08.02.2021, me objekt “Furnizimin me ujë zonat bregdetare plazhi gjeneralit-karpen–synej loti I”, të lidhur ndërmjet OE të sipërpërmendur dhe Bashkisë Kavajë, për Situacionin Pjesor nr. 8, likuiduar me Udhër Shpenzimin nr. 425, datë 13.03.2023, në vlerën 8,845,032 lekë (ku është zbritur edhe 5% i garancisë së punimeve në vlerën 465,528 lekë);
5. Fatura tatimore me nr. 11/2022, datë 28.02.2022, në vlerën 99,850,600 lekë me Tvsh lëshuar nga OE “G. C.” Shpk që i përket Kontratës së Punimeve me nr. 1534/2 prot., datë 07.05.2020, me objekt “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës për furnizimin me ujë të qytetit Kavajë dhe ndërtimi i Depo Uji e re, faza e dytë”, të lidhur ndërmjet OE të sipërpërmendur dhe Bashkisë Kavajë, për Situacionin Pjesor nr. 4, likuiduar me Udhër Shpenzimin nr. 1902, datë 21.11.2023, në vlerën 94,858,070 lekë (ku është zbritur edhe 5% i garancisë së punimeve në vlerën 4,992,530 lekë);
6. Fatura tatimore me nr.83/2023, datë 26.05.2023, në vlerën 150,086,475 lekë me Tvsh lëshuar nga OE “G. C.” Shpk që i përket Kontratës së Punimeve me nr. 2296/8 prot., datë 26.09.2022, me objekt “Riforcim i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4 faza I”, të lidhur ndërmjet OE të sipërpërmendur dhe Bashkisë Kavajë, për Situacionin Pjesor nr. 1, likuiduar me Udhër Shpenzimin nr. 2079, datë 22.12.2023, në vlerën 142,582,151 lekë (ku është zbritur edhe 5% i garancisë së punimeve në vlerën 7,504,324 lekë).

c. Subjekte përjashtuar nga procedura e Prokurorit:

Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë konstatohet se, në 1 rast janë zhvilluar projekte artistike për të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, prashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Analiza e detajuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i projektit	Urdhër Shpenzimi		Vlera
		Nr.	Datë	
1	Aktivitet kulturor “K. F. Sh.”	1726	02.11.2023	200,000
Totali				200,000

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

- Urdhri nr. 865, datë 01.11.2023, i Kryetarit të Bashkisë z. F. Q. me objekt “Për pagesën e në llogari të T. F.” përfaqësuar nga E. K., bazuar kontratës 3461/1 prot., datë 14.08.2023.

- Nga Bashkia Kavajë për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, për 1 subjekt është likuiduar shuma **200,000 lekë e cila përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi të prokurimit publik**, duke i përjashtuar këto procedura. Fondet për realizimin e këtij projekt janë parashikuar në buxhetin vjetor të Bashkisë Kavajë miratuar me VKB nr. 120, datë 27.12.2022, “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Kavajë për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr. 2388/1 prot., datë 04.01.2023.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. F. Q. Kryetar i Bashkisë Kavajë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe **znj. F. Gj.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike në cilësinë e nëpunësit zbatues për parregullsitë e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare.

d. Mënyra e mbajtjes së dokumentacionit ligjor për lëvizjen e mjeteve:

Në gjendjen e inventarit të Bashkisë Kavajë në të cilën përfshihet edhe Sektori i MZSH-së ndodhen në total 26 mjete/makineri dhe pajisje në gjendje pune, të llojit: autoveturë, furgon, kamion, eskavator me zinxhirë, traktor, zjarrëfikëse, etj., të cilat përbëjnë flotën e mjeteve të institucionit. Të dhënat në mënyrë të përmblëdhur paraqiten si më poshtë:

Nr.	Institucioni	Mjetet/makineri dhe pajisje në dispozicion
1	Aparati i Bashkisë Kavajë	24
2	Sektori i MZSH-së	2
Totali		26

- Për këto mjete nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e mjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to, gjithashtu të evidentohet kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe në fund të vitit, për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj. Këto shpenzime nuk mund të përllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi pronësinë e mjeteve, me zgjedhje u konstatua se, 26 mjete nuk janë të pajisura me çertifikatë të kontrollit teknik dhe 3 mjete nuk janë të pajisura me policë

për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike, për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi pronësinë e mjeteve me zgjedhje, u konstatua se, për 3 mjete të tipit mjet vetëshkarkues, mini eskavator dhe zjarrëfiksjë e modelit S. nuk janë të regjistruar në regjistratat publikë, pra nuk disponojnë çertifikatën e pronësisë dhe lejen e qarkullimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 10, neni 19, dhe neni 22, Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, neni 4, gërma “a”, Ligjin nr. 32/2021, datë 16.03.2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 2, pika 1, gërma “a”, Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58, neni 113 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 5-10, dhe pikat 35-36. Në mënyrë analitike paraqiten të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Siguracion	Kontroll teknik
1	B.	Po	Jo
2	Eskavator me zinxhirë V. Model F....	Po	Jo
3	Autoveturë tip M. (K....)	Po	Jo
4	Kamion M. (T....)	Po	Jo
5	Kamion vetëshkarkues 7 ton (K....)	Po	Jo
6	Kamion vetëshkarkues 20 ton (K....)	Po	Jo
7	Fadromë me targë V....	Po	Jo
8	Eskavator rrugor V. (K....A)	Po	Jo
9	M. B. M.... (A....)	Po	Jo
10	Automjet W. tip B.. (A....)	Po	Jo
11	Automjet W... tip B.. (A....)	Po	Jo
12	O....	Po	Jo
13	O....	Po	Jo
14	Veturë Naftë M... (A....)	Po	Jo
15	Veturë Naftë M. P. B. (A....)	Po	Jo
16	V. T.	Po	Jo
17	B..	Po	Jo
18	Automjet Zjarrëfikës “L..	Po	Jo
19	Automjet Zjarrëfikës S..	Jo	Jo
20	H. S. F..	Po	Jo
21	K....	Po	Jo
22	P....	Po	Jo
23	P....	Po	Jo
24	A....	Po	Jo
25	Mjet vetëshkarkues	Jo	Jo
26	Mini Eskavator	Jo	Jo

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

➤ **Normativat mbi konsumin e karburantit:**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, për vitin 2023 Bashkia Kavajë nuk ka normativa të miratuara për konsumin e karburantit të mjeteve të flotës së insitucionit konkretisht nuk është kryer një analizë mbi konsumin e karburantit pra nuk janë kryer testime në rrugë urbane dhe nacionale apo rurale (në varësi të përdorimit të mjetit) në të cilën të evidentohen kilometrat në fillim dhe në fund të lëvizjes së mjetit (për 100 km) me qëllim pasqyrimin sa më real mbi përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 10, neni 19, dhe neni 22.

➤ **Mbi mënyrën e përlogaritjes së kilometrave apo orëve të punës:**

Nga auditimi konstatohet se për të gjitha mjetet që kanë si njësi matëse orët mbi kryerjen e volumeve të punës nuk disponohet i instaluar në to asnjë orë matës.

➤ **Furnizimi i mjeteve:**

Furnizimit me karburant i flotës së mjeteve të institucionit është kryer nëpërmjet karatve elektronike. Bashkëlidhur faturës përmbledhëse mujore e cila lëshohet nga operatori ekonomikë

dhe fletë-hyrjeve, fletë-daljeve nga magazina, nga drejtuesit e mjeteve nuk disponohen kuponat tatimor dokument i cili përmban targën e mjetit, datën, sasinë mbi furnizimin e realizuar.

➤ **Auditimi me zgjedhje mbi konsumin e karburantit për mjetet:**

Me zgjedhje janë audituar shpenzimet mbi konsumin e karburantit për 7 mjete të flotës për një periudhë 6 mujore (e cila evidentohet në vijim të akt-konstatimit) për të cilën sipas fletë-daljeve nga magazina është tërhequr sasia prej 7,948 litra në vlerën 1,505,840 lekë nga punonjësit e institucionit si më poshtë:

1. z. E. G. ka tërhequr sasinë 1,650 litra karburant në vlerën 315,270 lekë;
2. z. B. M. ka tërhequr sasinë 150 litra karburant në vlerën 29,248 lekë;
3. z. A. K. ka tërhequr sasinë 200 litra karburant në vlerën 41,600 lekë;
4. z. K. L. ka tërhequr sasinë 1,780 litra karburant në vlerën 327,625 lekë;
5. z. S. H. ka tërhequr sasinë 230 litra karburant në vlerën 44,847 lekë;
6. znj. Xh. G. ka tërhequr sasinë 2,500 litra karburant në vlerën 484,155 lekë;
7. znj. P. M. ka tërhequr sasinë 1,438 litra karburant në vlerën 263,095 lekë.

Nga punonjësit e mësipërm karburanti është tërhequr nga magazina e institucionit sipas fletë-daljeve dhe plan shpërndarjes mujore si më poshtë:

1. Fletë-dalja nr. 10, datë 31.01.2023;
2. Fletë-dalja nr. 26, datë 28.02.2023;
3. Fletë-dalja nr. 61, datë 31.03.2023;
4. Fletë-dalja nr. 71, datë 28.04.2023;
5. Fletë-dalja nr. 85, datë 31.05.2023;
6. Fletë-dalja nr. 151, datë 31.10.2023;
7. Fletë-dalja nr. 146, datë 31.10.2023;
8. Fletë-dalja nr. 150, datë 31.10.2023;
9. Fletë-dalja nr. 149, datë 31.10.2023;
10. Fletë-dalja nr. 152, datë 31.10.2023;
11. Fletë-dalja nr. 143, datë 26.10.2023;
12. Fletë-dalja nr. 147, datë 31.10.2023;
13. Fletë-dalja nr. 145, datë 31.10.2023;
14. Fletë-dalja nr. 148, datë 31.10.2023;
15. Fletë-dalja nr. 130, datë 04.10.2023.

Plan shpërndarja mujore evidentohet në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë

Nr.	Targa	Janar 2023				Shkurt 2023				Mars 2023			
		Sasia	Çmimi litër	Totali	Punonjë që ka tërhequr karburantin	Sasia	Çmimi litër	Totali	Punonjë që ka tërhequr karburantin	Sasia	Çmimi litër	Totali	Punonjë që ka tërhequr karburantin
	A...	330	194.9	64,346	E. G.	500	191.2	95,638	E. G.	480	192.8	92,567	E. G.
	A....	150	194.9	29,248	B. M.	200	208	41,600	A. K.	580	192.8	111,852	K. L.
	K....	200	194.9	38,997	Xh. G.	0	-	0	-	200	192.8	38,569	Xh. G.
	K...	300	194.9	58,496	Xh. G.	150	191.2	28,691	Xh. G.	400	192.8	77,139	Xh. G.
	SH....	200	194.9	38,997	Xh. G.	50	191.2	9,563	Xh. G.	200	192.8	38,569	Xh. G.
	K.....	400	194.9	77,995	Xh. G.	0	-	0	-	400	192.8	77,139	Xh. G.
	A....	0	-	0	-	120	194.9	23,398	P. M.	318	192.8	61,325	P. M.
Totali		1,580	-	308,076	-	1,020	-	198,890	-	2,578	-	497,160	-

Lekë

Nr.	Targa	Prill 2023				Maj 2023				Tetor 2023			
		Sasia	Çmimi litër	Totali	Punonjë që ka tërhequr karburantin	Sasia	Çmimi litër	Totali	Punonjë që ka tërhequr karburantin	Sasia	Çmimi litër	Totali	Punonjë që ka tërhequr karburantin
	A...	340	184.4	62,719	E. G.	0	-	0	-	0	-	0	-
	A....	650	184.4	119,904	K. L.	550	174.3	95,869	K. L.	0	-	0	-
	A....	0	-	0	-	0	-	0	-	0	-	0	-
	K....	0	-	0	-	0	-	0	-	0	-	0	-
	K....	0	-	0	-	0	-	0	-	0	-	0	-

SH....	0	-	0	-	0	-	0	-	0	-	0	-
K....	0	-	0	-	0	-	0	-	0	-	0	-
A....	400	184.4	73,787	P. M.	600	174.3	104,585	P. M.	0	-	0	-
Totali	1,390	-	256,410	-	1,150	-	200,454	-	-	-	-	-

-Nga auditimi i konsumit të karburantit të flotës së mjeteve të Bashkisë Kavajë konstatohet se, nuk disponohet asnjë dokumentacion justifikues dhe vërtetues (fletë udhëtimi, autorizim, program pune, situacioni vëllimi punimesh etj.) për shpenzimin e sasisë prej 7,948 litra karburant naftë në vlerën 1,505,840 lekë. Për sa trajtuar më sipër vlera **1,505,840 lekë konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Kavajë**. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 10, neni 19, neni 22, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 5, pika 10, pika 19, pikat 35-36.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. R. K. ish-Kryetar i Bashkisë Kavajë në cilësinë e titullarit të institucionit dhe Nëpunësit Autorizues, **znj. F. Gj.** me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, **z. Sh. B.** ish-Drejtor Kabineti, **znj. P. M.** ish-Përgjegjës i Financë Kontabiliteti dhe **z. E. G., z. B. M., z. A. K., z. K. L., z. S. H., znj. Xh. G., dhe znj. P. M.** në cilësinë e punonjësve që kanë tërhequr karburantin.

Numri i punonjësve dhe fondi i pagave:

Pasqyra nr. 8, jep informacion mbi numrin e punonjësve, ndryshimet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur si dhe gjendjen në fund të periudhës, fondin e pagave gjithsej, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe informacion mbi tatimin mbi të ardhurat. Bashkëlidhur janë edhe llogaritë debitore dhe kreditorë në mënyrë analitike, si dhe evidencën përmbledhëse të përdorimit të fondeve.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit nga Bashkia Kavajë është paraqitur observacioni me shkresën 4479/4 prot., datë 08.11.2024, dhe datë 06.11.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 1088/2 prot., datë 07.11.2024, dhe nr. 1088/3 prot., datë 11.11.2024, nga z. A. Ç. Skekretar i Përgjithshëm dhe nga ish-punonjësit z. E. G., z. B. M., z. A. K., z. K. L., z. S. H., z. K. B., znj. Xh. G. dhe znj. M. P. ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Ju falenderojmë për pasqyrimin e kundërshtimit tonë në Projekt Raportin e dërguar me nr. 1035/4 prot., datë 05.12.2024, të protokolluar në Bashkinë Kavajë me nr. 4479/5 prot., datë 06.12.2024, dhe shprehim shqetësimin tonë që në fund të tij, me dy rrjeshta refuzoni të merrni në konsideratë sqarimet dhe shpjegimet tona objektive dhe lehtësisht të verifikueshme nga ana juaj pasi mund të ballafaqoni punën e bërë nga secili nga ne në Bashki dhe në kushte jo të plotësuara, siç ua kemi shpjeguar dhe do ua rishpjegojmë në këtë observacion, pasi po të dispononim mjete të bashkisë, nuk kishim asnjë arsye të përdorimit mjetet tona të cilat përveç karburantit kanë një amortizim gjatë punës ose e thënë teknikisht një vlerë përdorimi për të cilën nuk kemi marrë asnjë pagesë.

Keni cituar dhe mbështeteni në shprehjen: Se keni protokollin e Bashkisë?.... Të nderuar auditues! Në asnjë institucion nuk regjistrohen fletë udhëtimeve e automjeteve në protokoll, pasi ato janë dokumentacion i brendshëm dhe nuk kategorizohen tek dokumentet arkivore që duhet të kalojnë nëpërmjet protokollit, nëse keni ndonjë shembull dërgojani Bashkisë që të ndryshojnë.

Asnjë grup i auditimit i mëparshëm i KLSH nuk ka rekomanduar që të kalojnë këto dokumente nga protokollit dhe ju të gjykoni që ne nuk e kemi zbatuar. Ne kemi dy vjet të larguar nga institucioni dhe nuk ka bazë ligjore që të na kërkohet ne dokumentacioni, për arsye se ne i kemi lënë aty dokumentat e gjithë aktivitetit tonë zyrtar në funksionet që kemi patur. Pra kundërshtojmë me të drejtë që shprehja “dëm ekonomik” nuk qëndron, pasi ju lutemi pasqyroni ju një dokument që vërtetoni se ne e kemi shpërdoruar apo përvetësuar këtë sasi naftë të harxhuar, është detyrë e juaja që ta vërtetoni këtë shprehje, pasi ne pranojmë që duhet të kishim qenë të kujdesshëm më shumë, por funksionet kanë qenë të ndara dhe siç ju kemi sqaruar, ka qenë ish-specialistja e Sektorit të Shërbimeve znj. P. M. (aktualisht e larguar) dhe ajo mban përgjegjësi administrative apo ligjore, por jo ne ish punonjësit, pasi nuk ka përgjegjësi kolektive

ajo është individuale, si përfundim sqarimin tuaj si grup auditimi i KSLH për kundërshtimin e bërë për observimet tona për aktkonstatimin e mbajtur për këtë çështje nuk e pranojmë dhe nëse do të jetë nevoja do të përballemi me ju si institucion në organet e tjera ligjzbatuese, pasi me keqardhje shikojmë mungesë objektiviteti në vlerësimin e bërë nga ana juaj në Projekt Raport. Pretendimi juaj që gjeni dokumentacionin Ju është i pabazë, se jemi dy vjet të larguar nga Bashkia, ndërkohë që po të kërkonit më shumë aty është dokumentacioni, ne si ish punonjës ndjehemi shumë të pavlerësuar nga ana juaj. Sigurisht mbajmë përgjegjësi që nuk është bërë më e mira dhe të kishim një kujdes më të madh për administrimin e dokumentacionit, por jo të ndëshkohemi me përgjegjësi për dëm ekonomik për vlerë të llogaritur 1,719,737 lekë të sasisë karburantit 9,048 litra gazoil.

Më poshtë po ju paraqesim dhe një herë argumentat shteruese për trajtimin në faqe 48 deri faqe 50 të aktkonstatimit nr. 1, datë 27.09.2024, konkretisht:

Nisuar nga trajtimi që keni bërë në këtë material, duhet të ju sqarojmë se ne si ish punonjës apo ish nëpunës të Bashkisë Kavajë, në punën tonë jemi karakterizuar me frymën e zbatimit të ligjit dhe parimit të ndarjes së detyrave e rrjedhimisht të përgjegjësi në përmbushjen e detyrave tona funksionale. Kjo është shumë e rëndësishme pasi ne kemi patur funksione drejtuese e menaxhuese për mirëfunksionimin e administratës së Bashkisë në funksion të komunitetit tonë, por konstatohet se grupi i auditimit nuk e ka marrë parasysh këtë dhe na ka përgjegjësuar për një gjë që nuk na takon.

Gjatë përmbushjes së këtyre detyrave, sigurisht se ne nga Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Kavajë na është mundësuar përdorimi i mjeteve gjendje inventari të bashkisë. Nga ana jonë për çdo lëvizje me mjetet e bashkisë kemi plotësuar dokumentacionin përkatës sipas kërkesave ligjore dhe ju vëmë në dijeni se në periudha periodike kemi kryer rakordime me normat e konsumit të llogaritura dhe konsumit të karburantit siç e keni trajtuar Ju në faqen 50 dhe kemi zbatuar një plan shpërndarje të pasqyruar nga ana juaj me të drejtë për periudhën Janar 2023-Tetor 2023. Ju sqarojmë se në çdo muaj kemi paraqitur fletë udhëtimet e miratuara dhe pas llogaritjes së naftës konsumuar, na është dhënë furnizimi sipas plan shpërndarjes me përllogaritje të përafërta e sipas ngarkesës së punës tonë (sqarojmë se kemi punuar deri në orët e vona të natës për pastrimin e qytetit e të zonave turistike, duke monitoruar të gjithë aktivitetin e bashkisë sipas përgjegjësi funksionale të ndara. Materialet dokumentare për llogaritjen dhe administrimin e tyre i ka administruar ish specialistja e sektorit të shërbimeve znj. P. M. (aktualisht e larguar) e cila ka mbikqyrur e menaxhuar të gjithë aktivitetin ekonomik të shpenzimeve të karburantit, mënyrën e administrimit, ruajtjes apo dorëzimit të dokumentacionit justifikues e argumentues, është përgjegjësi e saj dhe nuk mund ta pranojmë që të ngarkohemi ne si ish-punonjës për mos administrimin si duhet të dokumentacionit që kemi dorëzuar, prandaj ju lutemi vlerësoni drejt argumentet tona dhe mos na ngarkoni me pa të drejtë. Ju sqarojmë se karburanti është marrë me kartë dhe me fot mjeti të Bashkisë në pikën e karburantit, kjo është bërë për efekt pengimi mundësive abuzuese.

Ju vëmë në vëmendje se sipas standardeve të auditimit të jashtëm që përdor institucioni i nderuar i KLSH, nga ana juaj si grup auditimi duhet të përcaktohet përgjegjësia direkte tek personat konkret dhe jo të listohemi ne me sasinë 9,048 litra gazoil e vlerë të llogaritur 1,719,737 lekë (nuk keni cituar nëse është dëm ekonomik, këtë duhet ta vërtetoni apo mos përdorimi i shpenzimeve me mungesë dokumentacioni të plotë justifikues, pasi dokumentacioni i lëvizjes siç e pranoni edhe vetë është i rregullt por sipas pretendimit tuaj ndoshta me të drejtë, por kjo nuk është përgjegjësi e jona, adresojeni atë me profesionalizëm e sipas procedurave tek personi konkret që ka patur detyrë përgatitjen, llogaritjen dhe dokumentimin e konsumit të karburantit dhe ruajtjen e këtij dokumentacioni sipas ligjit të arkivave dhe ligjit të kontabilitetit. Ky veprim nga ana e grupit të auditimit është në kundërshtim të hapur me Ligjin nr. 154/2014, "Për organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" ku citohet shprehimisht në nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", se: "Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas rastit në fillim, përgjatë dhe ose në përfundim të veprimtarisë, duhet gërma "dh" citojmë (audituesi; shënim i ankuesve) të pyesë dhe të marrë përgjigje, me shkrim ose me gojë, nga subjektet e audituara ose punonjësit e tyre, brenda 1 jave nga data e paraqitjes së një kërkesë paraprake" gjë e cila nuk është bërë nga ana juaj, pasi nuk kemi asnjë kërkesë apo njoftim zyrtar direkt nga ana juaj, ose nëpërmjet Bashkisë Kavajë që të vinim të ju sqaronim e të na jepej mundësia për të marrë pjesë në këtë procedure auditimit, kjo do na jepte mundësinë të jepnim argumentet tona ligjore. Mendojmë se nëse nga ana juaj

nuk është zbatuar procedura ligjore e auditimit nga anëtarët e grupit të auditimit sipas Rregullores së Brendshme të KLSH nr. 197, datë 12.10.2022, i ndryshuar, konkretisht veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk plotësojnë kërkesat e Nenit 31, pika 1, faqe 28 ku citohet: Audituesi në Departamentin e Auditimit: "1. Kryen të gjitha detyrat audituese të ngarkuara, bazuar në dispozitat ligjore, standardet profesionale dhe etike Brenda afateve të miratuara...." Pra kjo pikë nuk është përmbushur nga audituesit, pasi mungon baza ligjore dhe profesionalizmi në percaktimin e përgjegjesive individuale të evidentuar për një parregullsi, pasi nuk mund të mbajme përgjegjësi ne personat e trajtuar në Akt Konstatim e ngarkuar me vlera monetare në mënyrë të padrejtë e të pa bazuar në akte ligjore e nenligjore, pasi ju nuk keni asnjë dokument vertetues se ne kemi shpërdoruar karburant, prandaj po të na therrisnit në takim apo ballafaqime do ju sqaronim, ju theksojme përgjegjësia bie mbi ish personat përgjegjës për dokumentimin dhe administrimin e tyre dhe ju sigurojme që adresoni përgjegjësinë tek personi direkt përgjegjës dhe jo tek ne. Mungesa e organizimit apo njoftimit për takim ballafaques e sqarues është në kundërshtim me detyrimin që ju ngarkon rregullorja në nenin 31, pika 12,13, faqe 28, ku citohet: Merr pjesë në të gjitha takimet/ballafaqimet që kryhen në subjektet e audituar, ku ka qene anëtar i grupit të auditimit", pra nuk është zbatuar rregullorja dhe standardet e KLSH dhe nuk do i pranojmë konkluzionet e padrejta nga ana juaj.

I nderuar Z.Kryetar i KLSH.

Të nderuar auditues.

Duke shpresuar se do të rimerni në konsiderate observacionet tona dhe argumentet ligjore të paraqitura më sipër, kërkojmë që të reflektohen në Raportin Përfundimtar të Auditimit pasi kemi besim tek Ju në gjykimin objektiv dhe të pavarur dhe kërkojmë të na hiqet shprehja e paapranueshme "Dëmi ekonomik" dhe dënimi kolektiv, pasi na cënon rëndë integritetin tonë si ish-punonjës të një institucioni të nderuar të Bashkisë Kavajë, pasi kemi punuar me vullnet e profesionalizem e kemi përmbushur detyrimet tona administrative, pa shmangur dhe e mirëpresim përgjegjësinë për parregullsi që nuk kanë sjellë pasoja për institucionin me publik dhe kjo vlen për ne që mos të perserisim në të ardhmen kur do punojmë në institucione publike. Po kështu kërkojmë që të na krijohen mundësitë për ballafaqim bazuar në Kreu V "Raportimi i auditimit", Neni 29 "Komente dhe shpjegime mbi projekt-raportin" ku citohet: 1. "Përpara nxjerrjes së raportit përfundimtar të auditimit, subjektit të audituar duhet t'i krijohet gjithnjë mundësia për të komentuar mbi projekt-raportin. "Kommentet dhe shpjegimet e bëra i dërgohen Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda 1 muaji nga data e marrjes së projekt-raportit. Këto komente dhe qëndrimi i audituesve ndaj tyre duhet të pasqyrohen në raportin përfundimtar..", kjo me qëllimin e mirë të ruajtjes së standardit që ka KLSH si institucioni suprem i auditimit dhe jo për të denigruar grupin e auditimit që ka kryer auditimin. Duam të sqarojmë grupin e auditimit se Rregullorja e brendshme e KLSH, Ligji organik dhe standardet sigurisht nuk janë për Bashkinë Kavajë, por ju risjellim në vëmendje se integriteti i juaj pasqyrohet tek subjekti nëpërmjet zbatimit të këtyre akteve dhe ligjit të KLSH. Ne nuk kemi patur asnjë qëllim të rendojmë poziten tuaj, por është e drejta jonë që të kërkojmë zbatimin e akteve ligjore, nenligjore e administrative dhe nga ju si auditues të jashtëm të KLSH, trajtimi i tyre u bë nga nevoja për të studiuar nga ne këto dispozita, por nuk kemi patur asnjë qëllim të keq, gjuha juaj e përdorur që nuk janë për Bashkinë Kavajë është e papranueshme dhe pa vend (ndaj lutemi hiqeni në Raportin Përfundimtar), pasi rëndon pozitën tuaj si KLSH dhe institucion i pavarur, pasi jemi ndjerë të denigruar si ish punonjës të administratës publike dhe këmbëngulim në të drejtën tonë morale dhe ligjore. Mbetemi me shpresë dhe besim tek institucioni juaj i nderuar se do jeni mirëkuptues, duke mos na cenuar integritetin tonë me pa të drejte, pasi kemi punuar në përkushtim për të përmbushur detyrimet ligjore ndaj komunitetit.

Në pritje të reflektimit nga ana juaj të shpjegimeve shteruese të dhëna dy herë, por nga ana juaj herën e parë nuk u vlerësuan objektivisht e me profesionalizëm. Në të kundërt ne do ndjekim rrugët ligjore dhe do të përballemi në çdo hallkë gjyqësori, sepse kemi në drejtë e po na rëndoni padrejtësisht.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Së pari: Në thelb nga Ju nuk paraqiten observacione në lidhje me gjetjen e konstatuar nga Grupi i Auditimit (fakte apo prova të reja përveç dokumentacionit shtesë vetëm për dy ish-punonjësit e trajtuar në vijim të observacionit) por është kryer një auditim mbi auditimin e ushtruar nga KLSH. Për sa trajtuar

më sipër ju kujtojmë që Rregullore e Brendshme e KLSH dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit është një dispozitë ligjore që shërben për organizimin dhe funksionimin e KLSH dhe jo të Bashkisë Kavajë, pra respektimi apo mos respektimi i rregulloreve nga audituesit e KLSH mbetet për t'u analizuar nga strukturat përkatëse të institucionit konkretisht Departamenti i Shqyrtimit, Mbikëqyrjes dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit dhe Zbatimit të Standardeve.

Së dyti: KLSH publikon të gjitha Raportet e Auditimit në faqen Web të institucionit dhe nuk është e nevojshme që të na vihen në dukje detyrimin mbi transparencën institucionale të KLSH. Sikurse keni cituar edhe Ju, observacioni është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit me të gjithë elementët që keni përshkruar sipas shkresave të sipërpërmendura. Ju bëjmë me dije se evidentimi dhe trajtimi i observacioneve në Projekt Raport apo Raportin Përfundimtar kryhet në çdo proces auditues pra Bashkia Kavajë nuk hyn në rastet përjashtimore.

Së treti: Observacioni i paraqitur nga Ju në lidhje me justifikimin e shpenzimeve të karburantit është jashtë kontekstit, për arsye se nuk është paraqitur asnjë dokumentacion për justifikimin e sasië së karburantit. Ju jeni ngarkuar me përgjegjësi në cilësinë e personave që keni tërhequr sasinë e karburantit sipas fletë-daljeve nga magazina. Për më tepër nuk disponohet asnjë shkresë në të cilën parashtrohen pretendimet që ka qenë një punonjës tjetër i cili administron këtë dokumentacion.

Së katërti: Për sa i përket situatës që Ju si ish-punonjës nuk jeni bërë me dijeni nga grupi i auditimit mbi problematikën e sipërpërmendur ju citojmë se:

Grupi i auditimit ka komunikuar me Punonjës in i cili ka qenë pikë kontakti me grupin e auditimit, ku është kërkuar të paraqiten jo vetëm për Ju por të gjithë punonjës it që kanë përfituar karburant sipas fletë-daljeve nga magazina për periudhën përkatëse trajtuar në aktkonstatmin nr. 1. Përgjigja e institucionit (Bashkisë Kavajë) ka qenë e tillë që punonjës it nuk janë në marrëdhënie pune dhe disa prej tyre nuk ndodhen në Shqipëri nga kominikimet që kanë kryer punonjës it e bashkisë me Ju. Për më tepër në vijim të zbatimit të Rregullores së Procedurave të Auditimit, grupi i auditimit ka përcjellë pranë institucionit Bashkia Kavajë, në postën elektronike të pikës së kontaktit z. A. Ç. shkresën për njoftimin e të gjithë ish-punonjës ve të Bashkisë Kavajë që janë ngarkuar me përgjegjësi në lidhje me problematikat e trajtuara mbi justifikimin mbi shpenzimet e karburantit. Më datë 10.01.2025, është zhvilluar Takimi i Mirëkuptimit në ambientet e KLSH, ku vetëm dy prej ish-punonjës ve kanë qenë prezent ku është është lënë afat deri më datë 13.01.2025, për paraqitjen e dokumentacionit justifikues mbi shpenzimet e karburantit ku vetëm këta dy të fundit kanë paraqitur dokumentacion ku janë kryer reflektimet përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit duke u trajtuar në mënyrë analitike në vijim të këtij observacioni.

Së pesti: Siç e kemi trajtuar në mënyrë analitike në Aktkonstatimin nr. 1, datë 27.09.2024, dhe Projekt Raportin e Auditimit mënyrën e tërheqjes së karburantit nëpërmjet fletë-daljeve përkatëse nga magazina e institucionit Bashkia Kavajë. Për më tepër Ju bini ndesh me pretendimet e ngritura në këtë observacion pra citoni se me të drejtë grupi i auditimit e ka konstatuar këtë problematikë pro nuk është përgjegjës ia e ish-punonjës ve të Bashkisë Kavajë. Ju vëmë në dukje se, duke qenë se nuk disponohet dokumentacion ligjërish përgjegjës ia shkon tek punonjës i që e ka tërhequr sasinë e karburantit.

Së gjashti: Duke marrë në konsideratë faktin që Ju i jeni adresuar për herë të dytë se do të përballeni duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore sepse trajtimi i çështjes nga audituesit e KLSH pa profesionalizëm, po ju vendos në dukje rekomandimin që do të lihet për këtë çështje konkretisht:

Kategoria B. Masa për shpërblim dëmi:

1.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Kavajë të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej 1,505,840 lekë si pasojë e shpenzimit të karburantit në mungesë të dokumentacionit vërtetues dhe justifikues nga nëntë punonjës (sipas listën në pikën nr. 2.1.) të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomik ndaj buxhetit të bashkisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

Në mungesë të dokumentacionit justifikues dhe vërtetues për sasinë e sipërpërmendur është shkaktuar dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë Kavajë, në kushte të tillë observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Bashkia Kavajë është paraqitur observacioni referuar emailit të datës 03.10.2024, ora 12:00, dërguar nga znj. M. P. në postën elektronike të KLSH-së në adresën zyrtare m...@klsh.org.al, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në përgjigje të shkresës Tuaj me nr. Prot., 4479/2, datë 27.09.2024, mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Kavajë, mbi shpenzimet e karburantit për periudhën Janar-Mars, ju bëjë me dije se:

Mjeti tip "W. T.", me targë A... është në funksion të Qendrës Ditore për Fëmijët me Aftësi Ndryshe "Ngjyrat e Jetës". Në këtë qendër marrin shërbime persona nga mosha 3-21 vjeç dhe punohet me kategori të ndryshme fëmijësh me aftësi të kufizuara, si: me sindromën Down, Spektrin Autik, Prapambetje mendore të shkallës së mesme etj.. Kjo qendër ka ofruar shërbim për 16 (gjashtëmbëdhjetë) fëmijë me aftësi të kufizuar që vijnë nga zonat urbane dhe rurale të qytetit të Kavajës. Shërbimi në këtë qendër ofrohet 5 (pesë) ditë në javë nga e hëna në të premte nga ora 07:30-15:30 duke nisur dhe përfunduar që nga transporti i fëmijëve nga shtëpia në qendër dhe anasjelltas. Shoqërimi i fëmijëve bëhet nga 2 (dy) mësues gjatë marrjes nga banesa dhe gjatë kthimit në të. Lidhur me shpenzimet e kryera për konsumin e karburantit për mjetin A..., fletë udhëtimet janë të dorëzuara dhe në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike. Fletë-udhëtimi përcakton tipin e mjetit, targën e mjetit, lëvizjen ditore të mjetit (bazuar në marrjen dhe shpërndarjen e fëmijëve në banesë), km për mbledhjen e fëmijëve dhe km për shpërndarjen e fëmijëve, personi i cili e ka mjetin në ngarkim (shoferi) nënshkruar prej tij, edukatorët shoqëruar nënshkruar prej tyre. Ju dërgoj bashkëngjitur fletë-udhëtimet për konsumin e karburantit për automjetin tip "W. T.", me targa A.... për periudhën janar-maj të vitit 2023, ku unë kam mbajtur pozicionin e Drejtorit të Shërbimeve Sociale, pranë Bashkisë Kavajë nga data 05.10.2021, me nr. prot., 3000, Urdhër Transferimi nr. 353, datë 05.10.2021, dhe deri me datë 06.07.2023, me Urdhër Largimi nga Detyra nr. 208, datë 06.07.2023, me nr. Prot., 2809, datë 06.07.2023.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së: Referuar dokumentacionit të paraqitur në observacion, konkretisht fletët e udhëtimet për muajt Janar-Maj të vitit 2023, **për justifikimin e sasisë prej 500 litra karburant në vlerën 98,846 lekë, observacioni merret në konsideratë dhe do të kryehen reflektimet përkatëse në Raportit Përfundimtar të Auditimit, por theksojmë se grupi i auditimit shprehet me rezervë në lidhje me vërtetësinë e këtyre dokumentacioneve për arsye se ky dokumentacion nuk është paraqitur në fazën së auditimit në terren por pas Takimit të Mirkuptimit të zhvilluar në KLSH më datë 10.01.2025.**

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Bashkia Kavajë është paraqitur observacioni me shkresën pa numër protokollit dhe pa datë, administruar në KLSH me praktikën nr. 1088/6 prot., datë 15.01.2023, nga z. K. B. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në vijim të takimit të mbajtur në institucionin e KLSH-së ditën e premte datë 10.01.2025, ora 10:00, në prezencën e 2 ish-punonjësve z. G. dhe znj. P. dhe pamundësinë time për të mos qenë prezent për shkak të një angazhimi familjar duke qenë jashtë kufinjëve ju bëjë me dije se:

Karburanti i ngarkuar në emër të B..., përgjegjës i shumë sporteve (K. B.). Lidhur me shpenzimet e kryera për konsumin e karburantit nëpërmjet fletë-justifikimit janë të dorëzuara për çdo muaj edhe në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike.

Fletë-justifikimi përcakton konsumin e karburantit;

Për nivelimin dhe rulimin e fushës së vjetër;

Kaldajë për ngrohjen e dusheve për larjen e sportistëve;

Skuadra e Çiklizmit;

Shënim: Bashkëlidhur po ju dërgojë kopjet e fletë-justifikimeve për 4 muajt të vitit 2023:

-Janar 2023

-Shkurt 2023

-Mars 2023

Prill 2023.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së: Referuar dokumentacionit të paraqitur në observacion, konkretisht fletët e udhëtimet për muajt Janar-Prill të vitit 2023, **për justifikimin e sasisë prej 600 litra karburant në vlerën 115,051 lekë, observacioni merret në konsideratë dhe kryehen reflektimet përkatëse në**

Raportit Përfundimtar të Auditimit, por theksojmë se grupi i auditimit shprehet me rezervë në lidhje me vërtetësinë e këtyre dokumentacioneve për arsye se ky dokumentacion nuk është paraqitur në fazën së auditimit në terren por pas Takimit të Mirkuptimit të zhvilluar në KLSH më datë 10.01.2025.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare të Bashkisë Kavajë për vitin ushtrimor 2023 janë depozituar pranë Degës së Thesarit (DTH) Kavajë me shkresën nr. 3472 prot., datë 26.06.2024, dhe konfirmuar nga DTH me shkresën nr. 147 prot., datë 27.06.2024, jashtë afatit ligjor. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli V. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike të merren masa që hartimi dhe depozitimi i pasqyrave financiare vjetore, pranë degës së thesarit, të kryhet brenda afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore përkatëse.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Kavajë janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:

a. Përbërja e komisionit të inventarizimit të aktiveve të institucionit dhe njërive të varësisë është i njëjti për vitet 2022-2023;

b. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t’i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit;

c. Në listën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cilat konsiderohen të dëmshme, për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore. Nga Kryetari i Bashkisë nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre dhe nuk disponohet asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejin e asgjësimit dhe groposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet.

Vlera totale e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit është 68,277,063 lekë. Komisioni për tjetërsim dhe asgjësim, me shkresën nr. 4704/1 prot., pa datë, ka mbajtur procesverbalin lidhur me kryerjen e asgjësimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit. Nga të dhënat e evidentuara në procesverbalin e sipërpërmendur nuk vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion, mënyra e asgjësimit, transportit si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar; Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, VKM nr. 957, datë 19.12.2012, “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, Kreu I, pika 1, dhe pika 2, dhe Udhëzimin nr. 30,

datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 84, pika 85, germa “c”, pika 122. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa që përbërja e anëtarëve të komisioneve për inventarizimin e aktiveve të institucionit mos të jetë e njëjtë me atë të vitit të mëparshëm.

2.2. Rekomandimi: Nga komisionet e inventarizimit të aktiveve, pas përfundimit të procesit të inventarizimit, të paraqitet para nëpunësit autorizues raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit.

2.3. Rekomandimi: Nga komisionet për asgjësimin e aktiveve të merren masa që gjatë zhvillimit të procesit të asgjësimit, të respektohen kriteret për mbrojtjen e mjedisit si dhe të dokumentohet i gjithë procesi sipas kriterëve të përcaktuara në dispozitat ligjore.

Menjherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2023, në vlerën 630,530,197 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 772,025,004 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 772,025,004 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 182,845,257 lekë. Llogaria “Disponibilitete në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 182,845,257 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 49-50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

4. Gjetje nga auditimi: Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 45,196,292 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 20,194,738 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 25,001,554 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 26,443,939 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 7,531,853 lekë me një diferencë në vlerën 18,912,086 lekë pasi nuk pasqyrohet saktë gjendja e llogarisë 32 “Inventar i imët”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 4.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike, në pasqyrat financiare të vitit 2024, të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 32 “Inventar i imët” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë, duke kuadruar me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.

Deri më datë 31.03.2025

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të Klasës 4, konkretisht llogarive të arkëtueshme konstatohet se:

a. Nga auditimi i të dhënave analitike progresive konstatohet se çelja e llogarisë 411 *“Klientë e llogari të ngjajshme”* më datë 01.01.2023, është në vlerën 2,123,904 lekë ndërkohë që në pasqyrat financiare çelja për këtë llogari është në vlerën 2,839,350 lekë me një diferencë në vlerën 715,446 lekë. Në gjendjen e kësaj llogarie janë përfshirë detyrimet që kanë çerdhet dhe kopshtet e qytetit nga bashkisë. Llogaria 411 *“Klientë dhe llogari të ngjajshme”* është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitoare të llogarisë 468 *“Debitorë të ndryshëm”*, në kredi të llogarisë 4341 *“Operacione me shtetin (detyrime)”* në pasiv të bilancit.

b. Llogaria 423,429 *“Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)”*, e pasqyruar në bilanc për vlerën 91,540,628 lekë është e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie.

c. Gjendja e llogarisë 468 *“Debitorë të ndryshëm”* më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 708,667,017 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 747,814,846 lekë me një rritje në vlerën 39,147,829 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 *“Debitorë të ndryshëm”* nuk janë të përfshirë debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në shkresën me nr. 2257 prot., datë 19.04.2024, që Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të Ardhurave dhe Borxhit drejtuar Drejtorisë së Burimeve Ekonomike mbi borxhin tatimor progresiv më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 747,814,846 lekë pa përfshirë debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 *“Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”* me kundërparti llogarinë 468 *“Debitorë të ndryshëm”*, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, *“Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*, pika 3.2, pika 4.2, pika 5, pika 7, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për analizimin, zbërthimin e dokumentacionit ligjor për diferencën në vlerën 715,446 lekë që i përket çeljes së llogarisë 411 *“Klientë e llogari të ngjajshme”* me qëllim saktësimin e vlerave në pasqyrat financiare.

5.2. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogarinë 423 dhe 429 *“Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)”* të kontabilizuara në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.

5.3. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave, të Ardhurave dhe Borxhit të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 *“Debitorë të ndryshëm”* me kundërparti llogarinë 470 *“Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”*.

Deri më datë 31.03.2025

6. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 *“Studime dhe kërkime”* më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 123,926,424 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 125,701,505 lekë me një rritje në vlerën 1,775,081 lekë. Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej

122,396,352 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, për projekt-studime të pa analizuara për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik. Për këto vlera duhet të detajohen sipas investimeve dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu për llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*” nuk është përlllogaritur normë amortizimi. Këto veprime janë në kundërshtim me SKK nr. 5, “*Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale*” i përmirësuar, pikat 66-69; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”, Seksioni II “*Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar*”, pika 1/b; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”; Kreu II, Aneksi 1, pika 2, klasa 2, pika 5 dhe germa “d”, pika 36 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 122,396,352 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara, si dhe aplikimin e normës së amortizimit për llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*” duke përmbushur njëkohësisht dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.03.2025

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*” konstatohet se, për llogarinë 210 “*Troje, toka, terrene*” është përlllogaritur normë amortizimi në vlerën 878,207 lekë. Bazuar në SKK nr. 5, “*Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale*” i përmirësuar, pika 30, për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2024 të bëjë sistemimin e vlerës 878,207 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 210 “*Toka, troje, terrene*” si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.03.2025

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të Klasës 20, konkretisht aktiveve afatgjata materiale konstatohet se:

a. Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*” e pasqyruar në bilanc për vlerën 35,121,363 lekë dhe llogaria 211 “*Pyje, kullota, plantacione*” në vlerën 10,971,000 lekë, janë të pa analizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari.

b. Në gjendjen e llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” në vlerën 1,261,507,049 lekë kosto historike është përfshirë vlera 263,494,134 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë (në formë tabelore në programin E..) e pa analizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Pjesë e analizës së kësaj llogarie janë kontabilizuar 5

objekte pa vlerë me emërtimin “Njësia Administrative Golem”; “Shkolla 9 vjeçare Golem”; “Shkolla 9 vjeçare Qerret”; “Shkolla 9 vjeçare Kanaparaj”; “Shkolla 9 vjeçare Karpen”.

c. Në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,434,747,420 lekë kosto historike është përfshirë vlera 569,988,759 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë (në formë tabelore në programin E..) e pa analizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me SKK nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, Kapitulli “Trajtimi Kontabël për Aktivet Afatgjata të Investuara”, pikat 47-54; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor të llogarive aktiveve afatgjata të Klasës 20, (210, 212, 213) për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më datë 31.03.2025

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave analitike progresive të llogarisë 215 “Mjete transporti” më datë 31.12.2023, gjendja e aktiveve të kësaj llogarie paraqitet në vlerën 86,262,823 lekë, ndërkohë që nga të dhënat e kontabilizuara në Pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata neto (Vlera neto)” mbyllja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 115,814,921 lekë kosto historike me një diferencë në vlerën 29,552,098 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Nomenklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik, Kodi nr. 2, Artikulli nr. 21, Llogaria 215 “Mjete transporti”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për analizimin, zbërthimin e dokumentacionit ligjor për diferencën në vlerën 29,552,098 lekë që i përket koston historike të llogarisë 215 “Mjete transporti” me qëllim saktësimin e vlerave në pasqyrat financiare dhe në inventarin fizik.

Deri më datë 31.03.2025

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është mbivlerësuar në vlerën 599,090,510 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Kavajë është 653,394,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Kavajë sipas Marrëveshjes “Për krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime SHA Durrës” me nr. 1567 prot., datë 25.07.2022, është 55,538,490 lekë ose 8.5%. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Futboll Club Besa është 160,000,000 lekë. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Kavajë është 59,200,000 lekë ose 37%. Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 713,829,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me SKK nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, SKK nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-

30, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1, pika 2, “Aktivet afatgjata” (Përbërja dhe trajtimi kontabël)”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomie të marren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Deri më datë 31.03.2025

11. Gjetje nga auditimi: a. Gjendja e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 1,512,285,441 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 2,842,855,911 lekë me një rritje në vlerën 1,287,219,125 lekë. Vlëra e mbetur në fund të vitit 2022 prej 1,512,285,441 lekë është e pa analizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për investimet në proces. Nga analiza e kësaj llogarie gjendja e çeljes në vlerën 1,512,285,441 lekë + shtesën e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 1,287,219,125 lekë jep totalin e llogarisë në vlerën 2,799,504,566 lekë ndërkohë që në bilanc mbyllja e llogarisë më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 2,842,855,911 lekë me një diferencë në vlerën 43,351,345 lekë.

b. Në gjendjen e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” janë kontabilizuar aktivet me objekt “Hartim projektim rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare B.” në vlerën 883,520 lekë dhe “Hartim projektim i zbatimit të rindërtimit kopsht çerdhe Golem” në vlerën 891,561 lekë të cilat duhet të përfshiheshin në llogarinë 230 “Për aktivet afatgjata jo materiale”. Llogaria 230 “Investime për aktivet afatgjata jo materiale” është nënvlerësuar në vlerën 1,775,081 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata (Përbërja dhe trajtimi kontabël)”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor të llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” për nxjerrjen e të dhënave për vlerën 1,512,285,441 lekë që i përket investimeve të kryer ndër vite dhe të diferencës ndërmjet çeljes dhe shtesave në vlerën 43,351,345 lekë, për të verifikuar saktësuat e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare.

11.2. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për sistemin e vlerës 1,775,081 lekë nga llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar, të kontratave në proces të projekteve duke i kontabilizuar në llogarinë 230 “Investime për aktivet afatgjata jo materiale”.

Deri më datë 31.03.2025

12. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 2,842,855,911 lekë dhe në total me të njëjtën vlerë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe

raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1, gërma “c”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të evidentojë pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

Deri më datë 31.03.2025

13. Gjetje nga auditimi: Për aktivet që i përkasin llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 106 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, gërmat “a-c”, për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që kontabilizimi në pasqyrat financiare i aktiveve që i përkasin aktiveve të Klasës 20 të kryhet duke u bazuar në dokumentacion pronësor të pasurisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhësja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 33,232,495 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 30,181,721 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 1,748,837 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 8,872,253 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 1,221,466 lekë, 464 “Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë” në vlerën 1,242,000 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 724,981,269 lekë ku totali shkon në vlerën 801,480,041 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 800,238,041 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandim: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

15. Gjetje nga auditimi: Në gjendjen e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është përfshirë vlera prej 150,519,696 lekë e përbërë nga vendime gjyqësore në vlerën 45,616,172 lekë + mallra dhe shërbime në vlerën 21,660,099 lekë + investime në vlerën 83,243,425 lekë të cilat duhet të kontabilizohen në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 3.2, Aneksi 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për sistemimin e vlerës 150,519,696 lekë të kontabilizuar gabim në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” duke i kontabilizuar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Deri më datë 31.03.2025

16. Gjetje nga auditimi: Vlera e detyrimeve më datë 31.12.2023, për llogarinë 42 “Detyrime ndaj personelit” sipas urdhër shpenzimeve dhe akt-rakordimit me Degën e Thesarit Kavajë është në vlerën 30,061,732 lekë ndërsa në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 30,181,721 lekë me një diferencë në vlerën 119,989 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për analizimin, zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për diferencën e paraqitur për vlerën 119,989 lekë që i përket llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit” me qëllim saktësimin e vlerave në pasqyrat financiare.

Deri më datë 31.03.2025

17. Gjetje nga auditimi: Llogaria 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 1,242,000 lekë është e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3 “Inventari, llogaritë e të tretëve si dhe llogarive financiare” (Përbërja dhe trajtimi kontabël i klasës 3, 4 dhe 5). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të analizojë vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare të llogarisë 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë” të kontabilizuara në vite.

Deri më datë 31.03.2025

18. Gjetje nga auditimi: a. Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Kavajë në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 182,845,257 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Nga auditimi i evidencave analitike të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” disponohet analiza përkatëse vetëm për vlerën 64,476,038 lekë ndërsa, diferenca prej 118,369,219 lekë është e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësimin e vlerave të kësaj llogarie.

b. Për 37 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Kavajë janë ngurtësuar fonde në vlerën 55,806,023 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Kavajë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 55,806,023 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të

pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.3, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4)”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për vlerën 118,369,219 lekë të pa analizuar në kontabilitet që i përket llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, me qëllim evidentimin dhe raportin e saktë në dokumentet kontabël të Njesisë.

Deri më datë 31.03.2025

18.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Ekonomike të marrin masa për analizimin e përdorimit për interes publik të fondeve që ju ka mbaruar periudha e garancisë, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Brenda datë 31.12.2025

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk paraqitet e saktë për arsye se, në analizat përkatëse vlera e kreditorëve është 725,081,269 lekë ndërsa në bilanc në vlerën 724,981,269 lekë me një diferencë mos kontabilizimi në vlerën 100,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 3.2, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4)”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për sistemimin e vlerës 100,000 lekë e cila ka të bëjë me mos kontabilizimin e të gjithë vlerës sipas analizës përkatëse që i përket detyrimeve që ka institucioni ndaj të tretëve në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Deri më datë 31.03.2025

20. Gjetje nga auditimi: Llogaria 16,17,18 “Huatë Afat Gjata” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 35,628,212 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, në vlerën 35,628,212 lekë. Përgjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime. Bashkia Kavajë ka marrë hua për ndërtimin e banesave sociale me afat 20 vjeçar (aktualisht viti i 11-të) bazuar në marrëveshjen date 13.02.2008, midis (CEB) dhe Bashkisë Kavajë për kredinë e marrë nga Banka Qendrore Europiane (CEB) me ndërmjetësimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në rolin e institucionit garant. Bazuar në kushtet e kësaj marrëveshjeje bashkia ka marrë përsipër pagesën e kështit të kredisë me specifikimin se “në rast të mosrespektimit të pagesave ministria e financës do ta mbajë këtë detyrim nga transfertat e buxhetit qendror”. Nga auditimi u konstatua se për vitet 2022-2023 nuk ka kryer pagesën e planifikuar për kështet vjetore në vlerën 7,670,516 lekë. Në pasqyrat financiare të Bashkisë Kavajë kjo hua duhet të pasqyrohet si shpenzim konkretisht: Në kredi të Pasivët Afat Gjata/klasa 4 llogari të pagueshme, hua afat gjatë; Në debi tek të tjera aktive afatshkurtra, llog 481, shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime. Nga Auditimi u konstatua se për vitet 2022-2023 nuk ka informacion sa i përket kredisë së marrë nga Banka Qendrore Europiane (CEB) me ndërmjetësimin e MFE në rolin e institucionit garant të këtij detyrimi. Në kontabilitetin e bashkisë kjo kredi është pasqyruar si huamarrje por nuk ka të dhëna kontabël ku të tregohet historiku i

transferimit të gjendjeve të llograive të kësaj veprimtarie. Për këtë huamarje Bashkia Kavajë nuk rezulton të ketë kryer pagesa për vitet 2022-2023 për këstet vjetore në vlerë 7,670,516 lekë. Bazuar në legjislacionin për kontabilitetin paraqitja e huasë në bilanc duhet: Në kredi të Pasivet Afat Gjata/klasa 4 llogari të pagueshme, hua afat gjatë; Në debi tek të tjera aktive afatshkurtra, llog 481, shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10-11, të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 3 pikat 4, 6., nenet 57-60, nenet 62, 63, 64, 67; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me UMF nr. 5, datë 21.02.2022, Aneksi 1, “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, si dhe në Udhëzimin e MFE nr. 34, datë 14.12.2022, “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike, të marrë masa për kryerjen e pagesave të planifikuara dhe të papaguara për kredinë e marrë nga Banka Qendrore Evropiane (CEB), në shumën 7,670,516 lekë të bëjë kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të llogarive në mënyrë që pasqyrat financiare të sigurojnë informacion të saktë për pozicionin financiar të kredisë.

Deri më datë 31.03.2025

21. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 6,950,179,622 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 112,297,766 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 7,531,853 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 331,059,987 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 226,160,610 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” është mbivlerësuar në vlerën 1,536,878,023 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 17. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

Deri më datë 31.03.2025

22. Gjetje nga auditimi: a. Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se Bashkia Kavajë përgjatë vitit 2023 ka kryer pesë pagesa në vlerën totale 6,108,740 lekë për shpronësimin e pasurive private me interes publik në zbatim të projektit “Unaza lindore Kavajë”. Nga auditimi konstatohet se bashkëlidhur praktikës shoqëruese të bankës, nuk disponohet urdhri për komisionin e posaçëm nga Agjencia Shtetërore e Shpronësimit (ASHSH),

për ndjekjen dhe realizimin e procedura të shpronësimit; akt-marrëveshja midis ASHSH dhe Bashkisë; kërkesa për shpronësim e cila duhej të administrohej pranë zyrës së protokollit pranë Bashkisë nga pronari i kësaj pasurie; përllogaritja e shpronësimit, në zbatim të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, *“Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të pasurisë pronë private në interes publik”* i ndryshuar dhe VKM nr. 138, datë 23.03.2000, *“Për kriteret e vlerësimit dhe përllogaritjes të masës të shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtat e personave të tretë, për interes publik”* i ndryshuar.

b. Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se në gjashtë raste (transaksione) në vlerën totale 367,736,891 lekë janë hasur vonesa në likuidimin e faturave pjesore apo përfundimtare (për situacionet e punimeve) të kontratave të punimeve, jashtë afate të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, *“Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”* neni 7 *“Afati për autoritetet publike”*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Ekonomike të marrë masa për kompletimin e dosjes së shpronësimit me dokumentacionin e munguar, konkretisht: certifikata e pronësisë, akt-marrëveshja midis ASHSH dhe Bashkisë Kavajë, dokumenti për përllogaritjen e shpronësimit dhe urdhri për komision të posaçëm nga ASHSH për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.

22.2. Rekomandimi: Bashkia Kavajë, Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë që të kryejë likuidimin e faturave ndaj operatorëve ekonomikë brenda afateve të parashikuara në ligj, për shmangien e krijimit të detyrimeve kontraktore.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Në gjendjen e inventarit të Bashkisë Kavajë në të cilën përfshihet edhe Sektori i MZSH-së ndodhen në total 26 mjete/makineri dhe pajisje në gjendje pune, të llojit: autoveturë, furgon, kamion, eskavator me zinxhirë, traktor, zjarrfikëse, etj., të cilat përbëjnë flotën e mjeteve të institucionit.

- Për këto mjete nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e mjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to, gjithashtu të evidentohet kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe në fund të vitit, për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj.,. Këto shpenzime nuk mund të përllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi pronësinë e mjeteve me zgjedhje u konstatua se 26 mjete nuk janë të pajisura me certifikatë të kontrollit teknik, 3 mjete nuk janë të pajisura me policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike, për përgjegjësinë ndaj palëve të treta dhe 3 mjete të tipit mjet vetëshkarkues, mini eskavator dhe zjarrfikësja e modelit S. nuk janë të regjistruar në regjistrat publikë, pra nuk disponojnë certifikatën e pronësisë dhe lejen e qarkullimi.

- Për vitin 2023 Bashkia Kavajë nuk ka normativa të miratuara për konsumin e karburantit të mjeteve të flotës së institucionit konkretisht nuk është kryer një analizë mbi konsumin e karburantit me qëllim pasqyrimin sa më real mbi përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit.

- Për të gjitha mjetet që kanë si njësi matëse orët mbi kryerjen e volumeve të punës nuk disponohet i instaluar në to asnjë orë matës. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, neni 10, 19, dhe 22; Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, *“Për transportet rrugore”* i ndryshuar, neni 4, germa “a”; Ligjin nr. 32/2021, datë 16.03.2021, *“Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”*, neni 2, pika 1, germa “a”; Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, *“Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”* i ndryshuar, neni 58 dhe, 113, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *“Për menaxhimin e aktiveve*

në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 5-10, dhe pikat 35-36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë, Drejtoria e Burimeve Ekonomike në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të institucionit të marrë masa për hartimin e kartelave përkatëse të mjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e mjeteve si dhe të pajisjen me certifikatë pronësie, dokumentin e kontrollit teknik dhe me policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike.

23.2. Rekomandimi: Bashkisë Kavajë të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për kryerjen e testimeve dhe miratimin e normativave të konsumit të karburantit për mjetet e flotës së institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë konstatohet se, në 1 rast është zhvilluar një projekt artistik i cili nuk është përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Miratimi i fondit për realizimin e këtij projekt është parashikuar në buxhetin vjetor të Bashkisë Kavajë miratuar me VKB nr. 120, datë 27.12.2022, “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Kavajë për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr. 2388/1 prot., datë 04.01.2023. Nga Bashkia Kavajë për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, për 1 subjekt është likuiduar shuma 200,000 lekë e cila përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi të prokurimit publik, duke i përjashtuar këto procedura. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Ekonomike të marrë masa që në çdo rast të shpenzimeve për aktivitete social-kulturore të jenë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, germa “b” dhe “c” “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së” dhe mbështetur në nenet 98-102 të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, nga ana e Titullarit të njësisë publike Bashkisë Kavajë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësisht, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,505,840 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i shpenzimeve për konsumin e karburantit për 7 mjete të flotës të Bashkisë Kavajë për një periudhë 6 mujore të viti 2023 për të cilën sipas fletëdaljeve nga magazina është tërhequr sasia prej 7,948 litra në vlerën 1,505,840 lekë nga 7 punonjës

të institucionit konstatohet se, nga Bashkia Kavajë nuk disponohet asnjë dokumentacion justifikues dhe vërtetues (*fletë udhëtimi, autorizim, program pune, situacion volumi punimesh etj.*) për shpenzimin e sasisë prej 7,948 litra karburant naftë në vlerën 1,505,840 lekë. Për sa trajtuar më sipër vlera **1,505,840 lekë konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Kavajë**. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, neni 10, neni 19, neni 22 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pika 5, pika 10, pika 19, pikat 35-36. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Kavajë të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej 1,505,840 lekë si pasojë e shpenzimit të karburantit në mungesë të dokumentacionit vërtetues dhe justifikues nga shtatë punonjës (sipas listës në pikën nr. 2.1.) të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomik ndaj buxhetit të bashkisë, duke ndjekur gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

C.1.1 PËR PUNONJËSIT TË CILËT JANË PJESË E SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të shkronjës “c” neni 15, “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në zbatim të nenit 58, “*Llojet e masave disiplinore*” të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar me Ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kavajë, që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “**Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet**”, për 1 punonjës të mëposhtëm:

1. Për Znj. F. Gj., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike në cilësinë e nëpunësit zbatues, nënshkrues i pasqyrave financiare, për shkeljet:

- Për depozitimin e pasqyrave financiare jashtë afatit ligjor në Degën e Thesarit;
- Llogaria 520 “*Disponibilitete në thesar*” është nënvlerësuar në vlerën 182,845,257 lekë;
- Për mos kuadrimin e diferencës së lëvizjes së inventarit në vlerën 7,531,853 lekë me llogarinë 63 “*Ndryshimi i gjendjes së inventarit*”;
- Për mos kontabilizimin e saktë të çeljes së llogarisë 411 “*Klientë e llogari të ngjashme*” me një diferencë në vlerën 715,446 lekë;
- Për kontabilizimin e vlerës 91,540,628 lekë që i përket llogarisë 423,429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)*” e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie;
- Për mos kontabilizimin e debitorëve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”;
- Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 122,396,352 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, për projekt-studime të pa analizuar për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme;

- Për llogarinë 202 *“Studime dhe kërkime”* nuk është përlllogaritur normë amortizimi.
- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b *“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”* konstatohet se, për llogarinë 210 *“Troje, toka, terrene”* është përlllogaritur normë amortizimi në vlerën 878,207 lekë;
- Llogaria 210 *“Toka, troje, terrene”* e pasqyruar në bilanc për vlerën 35,121,363 lekë dhe llogaria 211 *“Pyje, kullota, plantacione”* në vlerën 10,971,000 lekë, janë të paanalizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari;
- Në gjendjen e llogarisë 212 *“Ndërtesa e konstruksione”* në vlerën 1,261,507,049 lekë kosto historike është përfshirë vlera 263,494,134 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë (në formë tabelore në programin E..) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit;
- Në gjendjen e llogarisë 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* në vlerën 3,434,747,420 lekë kosto historike është përfshirë vlera 569,988,759 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë (në formë tabelore në programin E..) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit;
- Nga auditimi i të dhënave analitike progresive të llogarisë 215 *“Mjete transporti”* më datë 31.12.2023, gjendja e aktiveve të kësaj llogarie paraqitet në vlerën 86,262,823 lekë, ndërkohë që nga të dhënat e kontabilizuara në Pasqyrën nr. 7/b, *“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata neto (Vlera neto)”* mbyllja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 115,814,921 lekë kosto historike me një diferencë në vlerën 29,552,098 lekë.
- Llogaria 26 *“Pjesëmarrje në kapitalët e veta”*, është mbivlerësuar në vlerën 599,090,510 lekë;
- Llogaria 230 *“Investime për aktivet afatgjata jo materiale”* është nënvlerësuar në vlerën 1,775,081 lekë;
- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 *“Investime për aktive afatgjata jo materiale”* paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 *“Investime për aktive afatgjata materiale”* në vlerën 2,842,855,911 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 2,842,855,911 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 *“Nga fondet e veta të investimeve”* e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 *“Teprica e grandeve kapitale të brendshme”* në vlerën 0 lekë;
- Përmbledhësja e llogarive 401-408 *“Furnitorë e llogari të lidhura me to”* paraqitet në vlerën 33,232,495 lekë, 42 *“Detyrime ndaj personelit”* në vlerën 30,181,721 lekë, 431 *“Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”* në vlerën 1,748,837 lekë, 435 *“Sigurime shoqërore”* në vlerën 8,872,253 lekë, 436 *“Sigurime shëndetësore”* në vlerën 1,221,466 lekë, 464 *“Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë”* në vlerën 1,242,000 lekë dhe 467 *“Kreditorë të ndryshëm”* në vlerën 724,981,269 lekë ku totali shkon në vlerën 801,480,041 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 *“Operacione me shtetin (Të drejta)”* në vlerën 800,238,041 lekë.
- Në gjendjen e llogarisë 401-408 *“Furnitorë e llogari të lidhura me to”* është përfshirë vlera prej 150,519,696 lekë e përbërë nga vendime gjyqësore në vlerën 45,616,172 lekë + mallra dhe shërbime në vlerën 21,660,099 lekë + investime në vlerën 83,243,425 lekë të cilat duhet të kontabilizohen në llogarinë 467 *“Kreditorë të ndryshëm”*;
- Vlera e detyrimeve më datë 31.12.2023, për llogarinë 42 *“Detyrime ndaj personelit”* sipas udhër shpenzimeve dhe akt-rakordimit me Degën e Thesarit Kavajë është në vlerën 30,061,732 lekë

ndërsa në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 30,181,721 lekë me një diferencë në vlerën 119,989 lekë;

- Llogaria 464 *“Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë”*, e pasqyruar në bilanc për vlerën 1,242,000 lekë është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie;

- Gjendja e llogarisë 467 *“Kreditorë të ndryshëm”* nuk paraqitet e saktë për arsye se, në analizat përkatëse vlera e kreditorëve është 725,081,269 lekë ndërsa në bilanc në vlerën 724,981,269 lekë me një diferencë mos kontabilizimi në vlerën 100,000 lekë;

- Llogaria 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”* është mbivlerësuar në vlerën 1,536,878,023 lekë.

C.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për 8 (tetë) ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte *(Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet)* përkatësisht:

1. **Z. Sh. B.** me detyrë Drejtor i Kabinetit;
2. **Znj. P. M.** me detyrë Përgjegjës i Financë Kontabiliteti;
3. **Z. E. G.** me detyrë Zëvendës Kryetar;
4. **Z. B. M.** me detyrë Polic Bashkiak Sezonal;
5. **Z. A. K.** me detyrë Polic Bashkiak Njësia Administrative Golem;
6. **Z. K. L.** me detyrë Polic Bashkiak;
7. **Z. S. H.** me detyrë Polic Bashkiak;
8. **Znj. Xh. G.** me detyrë Drejtor i Agjencisë së Arsimit Parashkollor.

Shënim: Për punonjësit e tjerë të cilët kanë rezultuar me mangësi gjatë ushtrimit të detyrave të tyre institucionale, nuk rekomandojmë masa disiplinore, për shkak të nivelit të ulët të materialitetit sasior dhe cilësor si më poshtë:

1. **z. J. K.** me detyrë Drejtor Kabineti;
2. **z. M. K.** me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike;
3. **z. M. R.** me detyrë Kryeinspektor i IMTV;
4. **z. G. J.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kulturës;
5. **z. K. M.** me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore;
6. **z. E. N.** me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Helmas;
7. **z. S. P.** me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Golem;
8. **z. G. B.** me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Luz i Vogël;
9. **z. E. D.** me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Synej;
10. **z. B. K.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Shërbimeve Publike;
11. **z. R. T.** me detyrë Inspektor i Mbrojtjes së Territorit;
12. **znj. F. H.** me detyrë Specialist Kontrolli Shërbimesh (Gjelbërimi);
13. **znj. B. A.** me detyrë Specialist Inventari;
14. **znj. D. M.** me detyrë Specialiste Kontabiliteti;
15. **z. G. L.** me detyrë Specialist i Biznesit dhe të Ardhurave;
16. **znj. E. D.** me detyrë Inspektor në Agjencinë e Arsimit Parashkollor;

17. znj. E. O. me detyrë Përgjegjëse e Kulturës.

Për problematikat e konstatuara në lidhje me procesin e inventarizimit konkretisht: mos hartimin e raportit për inventarin fizik si dhe mos dokumentimin me të gjithë dokumentacionin justifikues të procesit nxjerrjen/asgjesimin e aktiveve jashtë përdorimit.

D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Kavajë, *të ndërmarrë veprimet si më poshtë:*

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013, *“Për Nëpunësin Civil”* i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013, *“Për Nëpunësin Civil”* i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT